

1 E hënë, 25 mars 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Mirëmëngjes, të gjithëve. Për procesverbal, të katër të
13 akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit.

14 Sot do të fillojmë me dëgjimin e dëshmisë së Dëshmitarit
15 të Prokurorisë 4147. Përpara sesa të fillojmë me këtë
16 dëshmitar, ka disa çështje që duam të trajtojmë.

17 Sa i takon ofertës së ZPS-së për pranimin e dy
18 dokumenteve në dëshminë e Dëshmitarit 04571, përkatësisht me
19 numër të përkohshëm prove materiale P0164 dhe më MFI P01065,
20 Trupi Gjykses vendos si më poshtë.

21 Sa i takon relevancës, Trupi Gjykses konstaton se ato
22 janë dokumente relevante pasi kanë të bëjmë me personat të
23 cilët pretendohet që janë viktimat të krimeve të cilët kanë të
24 bëjnë me këtë çështje dhe që kanë të bëjnë me dyshime të
25 lidhura me këta individë sa i takon shpjegimeve që ata kanë

1 dhënë gjatë luftës.

2 Për më tepër këto dokumente, janë relevantë për të
3 vërtetuar: Së pari natyrën e punës së përbashkët të kryer nga
4 bashkëpunëtorët e dyshuar si edhe shkallën apo nivelin e
5 aktiviteteve të tilla të dyshuara të kryera nga ky grup
6 bashkëpunëtorësh.

7 Sa i takon autenticitetit, Trupi Gjykses konstaton që nuk
8 ka informacion asgjë tjetër përvese faktit që këto janë
9 informacione të cilat janë mbledhur nga forcat zbulim
10 kundërzbulim dhe individë të cilët mund të jenë të dyshuar si
11 bashkëpunëtorë të autoritete serbe ose zyrtarëve serbë. Nuk ka
12 informacion që këto dokumente në të janë të ndërhyra dhe me aq
13 sa dihet këto janë thjeshtë dokumente të asaj kohe që kanë të
14 bëjnë me informacionin e përmbajtur në të.

15 ZPS-ja tregon që dokumentet janë sekuestruar nga
16 autoritetet serbe dhe më pas janë dhënë TPNJ-së.

17 Të dy dokumentet kanë të bëjnë me anëtarë të UÇK-së, me
18 takime dhe operacione të UÇK-së. Dëshmitari 04571 ka dhënë
19 dëshmi të drejtpërdrejt në sallën e gjyqit që është në pajtim
20 me shënimet e mbajtura me shkrim dore që ka të bëjë me lidhjet
21 e pretenduara, në veçanti, me oficerin e policisë serbe dhe
22 individë të tjerë të cilët përmenden në këto dokumente.

23 Dokumentet mbështesin pjesërisht shënimet me shkrim dore në
24 dëshmi, në veçanti P00651, që tregon që është lëshuar një
25 urdhër arresti për dëshmitarin përpara sesa ai të burgosej.

1 Së fundi, Mbrojtja nuk ka barrë sa i takon këtij aspekti
2 dhe Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka ofruar
3 shpjegime të besueshme se pse këto dokumente nuk duhet të
4 merren parasysh edhe nuk duhet të konsiderohen si informacione
5 të rëndësishme për këtë çështje gjyqësore.

6 Trupi Gjykses ka konstatuar në një vendim të mëparshëm,
7 që është parashtrimi i protokolluar F01963, paragrafi 28, që
8 nuk ka bazë për të sugjeruar që dokumentet e ofruar nga
9 autoritet serbe janë *prima facie* të dyshuara dhe që Mbrojtja
10 vetë ka ofruar dokumente të tillë për pranim në herë të tjera.
11 Për pasojë, Trupi Gjykses është i bindur që dokumentet janë
12 autentike *prima facie*. Në këtë konstatim, Trupi Gjykses
13 thekson që është mbështetur gjithashtu edhe në deklaratën e
14 një hetuesi të TPNJ-së në çështjen Haradinaj të dorëzuar nga
15 avokati i ZPS-së. Ky dokument është pjesë e procesverbalit në
16 këtë çështje gjyqësore dhe ofrohet për pranim.

17 Po ashtu sa i takon vlerës provuese të dokumenteve, Trupi
18 Gjykses përcakton sa më poshtë. Ndërkohë që Trupi Gjykses
19 duhet që të vërtetojë autorësinë e dokumenteve të tillë për të
20 vendosur për pranimin e tyre, Trupi Gjykses është i bindur që
21 përmbajtja është në pajtim me sugjerimin që është përgatitur
22 nga anëtarët e UÇK-së ose individë të tjerë të lidhur me ta.
23 Kjo është e dukshme nga natyra e pretendimeve të përmbajtura
24 në dokumente dhe nga emrat dhe identitetet e individëve të
25 cilët janë të lidhur me aktivitetet e përmendura në dokumente

1 të tjera.

2 Trupi Gjykses vëren për më tepër që nuk ka tregues që ka
3 ndonjë palë të tretë të përfshirë në mbikëqyrjen ose që ka
4 ndonjë interes të veçantë sa i takon ndonjërit prej
5 bashkëpunëtorëve të supozuar të përmendur dhe të listuar të
6 renditur në këto dokumente.

7 Së fundi, Trupi Gjykses vëren se përmbajtjet e dy
8 dokumente janë pjesërisht mbështetëse për aq kohë sa ato kanë
9 të bëjnë pothuajse me të njëjtët individë. Mbi këtë bazë,
10 Trupi Gjykses është i bindur që këto dokumente kanë vlerë
11 provuese *prima facie*.

12 Së fundi, fakti që dokumentet mund të përmbajnë
13 informacion të pasaktë ose të pavërtetë nuk cenojnë vlerën e
14 tyre provuese pasi ato nuk ofrohen për të vërtetuar
15 vërtetësinë e përmbajtjes së tyre, por siç është thënë
16 shprehimisht nga ZPS-ja, këto dokumente ofrohen për të
17 vërtetuar fakte ose pretendime që këta persona ishin individë
18 që janë trajtuar ose janë konsideruar si bashkëpunëtorë.

19 Sa i takon çështjes së paragjyimit, Trupi Gjykses vëren
20 që ekipet e Mbrojtjes kanë pasur mundësi që t'i bëjnë pyetje
21 dëshmitarëve, pra, Dëshmitarit 40571 sa i takon përmbajtjes së
22 dokumentit dhe Trupi Gjykses tha që do ta shtynte
23 vendimmarrjen e vet sa i takon pranueshmërisë së këtyre
24 dokumenteve derisa të dëgjonte pyetjet e bëra nga ekipet e
25 Mbrojtjeve. Trupi Gjykses është i bindur që pranimi i këtij

1 dokumenti nuk shkakton paragjykim të padrejtë për Mbrojtjen.

2 Mbështetur në atë çfarë u tha më sipër, Trupi Gjykses
3 pranon këto dokumente mbështetur në rregullën 138.

4 Znj. Sekretare, ju lutem caktoni numrat e provave
5 materiale për dokumente që përkohësisht kanë marrë numrin e
6 provës materiale P01064 dhe P1065.

7 Këtu përfundon urdhri gojor i Trupit Gjykses.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 dokumentet që më parë kanë marrë numrin e provës materiale
10 P01064, që ka pasur më herët numrin ERN U001-8211-001-8252 dhe
11 përkthimi i këtij dokumenti në gjuhën angleze do të marri
12 numrin e provës materiale P01064.

13 Një tjetër dokument i cili më përpara ka marrë numrin e
14 përkohshëm të provës materiale P01065 me numrin ERN 099952
15 deri në 099952 dhe përkthimi i tij në anglisht tani do të
16 marri numrin e provës materiale P01065.

17 Të dy këto dokumente janë klasifikuar si konfidencialë
18 për momentin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Prokuror,
20 dëshironi që të mbajmë të njëjtin klasifikim për momentin.

21 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi marrë
23 kohën e rishikuar të ekipeve të Mbrojtjes sa i takon
24 kundërpyetjeve për Dëshmitarin 04147 dhe të dëshmitarëve të
25 tjerë. E vlerësojmë shumë që e keni shkurtuar kohën për

1 kundërpyetje. Megjithatë, sa i takon Dëshmitarit 04739, ky nuk
2 ishte një prej dëshmitarëve për të cilët Trupi Gjykses kërkoi
3 rishikimin e kohës për marrjen në pyetje. Trupi Gjykses i
4 udhëzon Ekipet e Mbrojtjes që të rishikojnë kohën që i duhet
5 për të marrë në pyetje Dëshmitarin 4739 dhe të na japë një
6 vlerësim të kohës së tyre nesër.

7 Tani më lejoni që të jap disa sqarime sa i takon dëshmisë
8 së Dëshmitarit 4147.

9 Ka disa çështje që do të doja të trajtoja. Së pari,
10 kujtoj që Mbrojtësi i Viktimave ka kërkuar leje për të bërë
11 pyetje për dëshmitarin dhe Mbrojtja e Thaçit e ka kundërshtuar
12 këtë kërkesë. Trupi Gjykses do të vendosë lidhur me këtë
13 kërkesë në fund të pyetjeve të Prokurorisë për dëshmitarin.

14 A dëshiron ndonjëra nga palët që të thotë diçka tjetër
15 lidhur me këtë pikë nga Ekipet e Mbrojtjes? Mesa duket jo.

16 Përpara sesa të vazhdojmë me dëshmitarin, më lejoni që
17 t'ju kujtoj të gjitha palëve për disa nga pikat të cilat janë
18 mbuluar nga vendimi F01847 për informacionin që bie nën
19 mbrojtjen e rregullës 107, në veçanti e kam fjalën për
20 paragrafët 11, 21, 27, 29 edhe 34 të këtij vendimi.

21 Së pari, Trupi Gjykses autorizon praninë e përfaqësuesit
22 të qeverisë së Shteteve të Bashkuara sipas rregullës 107,
23 gjatë dëshmisë së dëshmitarit. Trupi Gjykses do të lejojë
24 personin që të konsultohet me dëshmitarin sipas nevojës.

25 Së dyti, Trupi Gjykses autorizon që fusha e veprimit të

1 marrjes së drejtpërdrejt në pyetje nga Prokuroria të këtij
2 dëshmitari të kufizohet në tri tema të autorizuara sipas
3 rregullës 107, së pari të pyetet lidhur me strukturën,
4 komandën dhe operacionet e UÇK-së, së dyti, të pyetet për
5 rolet dhe përgjegjësitë e veçanta individuale brenda UÇK-së,
6 përfshirë këtu dhe përfshirjen e lirimit të të burgosurve.
7 dhe, së treti, informacion të përgjithshëm lidhur me incidente
8 që kanë të bëjnë me ndalimin dhe keqtrajtimin e individëve të
9 lidhur me UÇK-në dhe tema të tjera të mbuluara nga deklaratat
10 e dëshmitarit.

11 Ky dëshmitar, ka konfirmuar që nuk ka njohuri personale
12 lidhur me aktivitetet e zbulim-kundërzbulimit të jashtme të z.
13 Veseli në periudhën nga nëntori i 1998 e deri në fund të
14 luftës dhe Trupi Gjykses nuk ka marrë ndonjë njoftim për sa i
15 takon autorizimit të kërkuar për sa i takon pyetjeve që duhet
16 t'i bëhen këtij dëshmitari lidhur me këtë çështje.

17 Së treti, Trupi Gjykses udhëzon Mbrojtjen të kërkojë
18 autorizim sipas rregullës 107 për kundërpjetje për çështje të
19 cilat nuk bien ekzaktësisht brenda temave që autorizohen nga
20 rregulla 107.

21 Trupi Gjykses nuk do të lejojë pyetje të cilat nuk
22 dëshmohet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me çështjet e
23 autorizuara sipas rregullës 107. Kur do të bëhen pyetje lidhur
24 me këtë pikë, pyetjet ose pala pyetëse duhet të jetë e gatshme
25 që të deklarojë se cilat janë linjat ose pistat e caktuara ku

1 do të bëhen pyetje sipas autorizimit të rregullës 107.

2 Trupi Gjykses rikujton që do të zbatohet në mënyrë të
3 rreptë të gjitha këto pika të cilat unë i përmenda më përpara.

4 Nuk e di në qoftë se palët dëshirojnë të ngrenë ndonjë
5 gjë lidhur me këto çfarë thamë deri tani. Nëse, jo, do i
6 kërkoja Asistentes së Seancës që të sjellë dëshmitarin në
7 sallë bashkë me përfaqësuesin e ambasadës amerikane.

8 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ndërkohë që po presim që të
9 vijjnë personat përkatës, dëshiroj që të ngre një çështje
10 organizative, logjistike.

11 Sa i takon radhës së dokumenteve që do të përdoren sot,
12 dokumentet 32, 34 dhe transkriptet e një video me datë 27
13 nëntor 1998. Janë të përfshira. Megjithatë, kur u konstatua me
14 Zyrën e Menaxhimit Gjyqësor, ato na thanë që kanë probleme me
15 transkriptet e këtyre dokumenteve. Kështu që, neve duam të
16 themi që numri i provës materiale 93 ka të bëjë me versionet e
17 rishikuara të transkripteve në dokumentet e renditura për
18 marrjen në pyetje të këtij dëshmitari.

19 Sa i takon parashtrimin të protokolluar 1848,
20 poshtëshënimi 98, duhet që të diskutohet në kuadrin e
21 dokumentit që është caktuar tanimë si P93. Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
25 Dëshmitar. Më dëgjoni?

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju dëgjoj shumë mirë.

2 Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistentja e
4 seancës tani do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne që
5 duhet ta lexoni në pajtim me rregullën tonë, pra, rregullën
6 sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave para DHSK-së numër
7 141(2). Ju lutem lexojeni me zë.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
9 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
10 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
11 vetëm të vërtetës dhe se nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për
12 të cilën kam dijeni.

13 DËSHMITARI: SHAUN BYRNES

14 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
16 Mund të uleni.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] A mund të them diçka përpara sesa
18 të fillojmë?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Dëshiroj të them që jam këtu me
21 kërkesë të Departamentit të Shtetit dhe të Prokurorisë së
22 Specializuar. Nuk kam ardhur këtu me nismën time vetjake.
23 Megjithatë e pranoj përgjegjësinë që të jap dëshmi duke marrë
24 parasysh pozicionin tim dhe përgjegjësitë e mia në Kosovë në
25 vitin 1998 dhe 1999. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Mund të uleni.

3 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, që
4 parashikohet që të zgjasë, pak a shumë, tre ditë e gjysmë.
5 Sikurse mund ta dini, Prokuroria do t'ju bëjë së pari pyetje
6 dhe pastaj do t'ju bëjnë pyetje Ekipet e Mbrojtjeve si dhe
7 anëtarët e Trupit Gjykses. Do t'ju bëjë pyetje edhe Mbrojtësja
8 e Viktimave.

9 Prokuroria ka kërkuar tre orë për t'ju marrë në pyetje.
10 Ekipet e Mbrojtjes kanë vlerësuar që do ju duhen 11.5 orë për
11 t'ju marrë në pyetje. Sa i takon vlerësimin për secilin prej
12 palëve, neve shpresojmë që avokatët do të jenë efikas në
13 pyetjet dhe Trupi Gjykses do të lejojë, gjithashtu, edhe
14 pyetje plotësuese në qoftë se përmbushen kushtet përkatëse.

15 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni qartë pyetjeve me fjali
16 të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund
17 t'i kërkonit avokatit përkatës që të përsërisë pyetjen ose mund
18 të thoni që nuk e kuptoni pyetjen për të marrë më shumë
19 qartësi lidhur me të. Po ashtu, ju lutem, na thoni se cila
20 është baza e njohurive për faktet dhe rrethanat për të cilat
21 do të pyeteni.

22 Në qoftë se ZPS-ja do t'ju bëjë pyetje lidhur me disa
23 saktësime, ju kujtojmë që në procesverbal duhet të thoni që
24 deklarata, përfshirë këtu dhe sqarimet dhe korrigjimet të
25 marra të gjitha së bashku, pasqyrojnë në mënyrë të saktë

1 deklaratën tuaj.

2 Ju lutem flisni përpara mikrofonit dhe bëni një pauzë
3 prej pesë sekondash përpara sesa t'i përgjigjeni pyetjes, po
4 ashtu flisni në ritëm të ngadaltë në mënyrë të tillë që t'ju
5 kapin përkthyesit.

6 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi përpara Trupit
7 Gjykues, nuk lejoheni që të diskutoni me askënd lidhur me
8 përmbajtjen e dëshmisë tuaj jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë
9 se ndonjë person ju bën pyetje jashtë sallës së gjyqit lidhur
10 me dëshminë tuaj, ju lutem na e thoni këtë gjë.

11 Trupi Gjykues e kupton që Prokuroria ka kopje të
12 printuara të deklaratave të mëparshme në mënyrë të tillë që
13 juve t'i drejtoheni në qoftë se është e nevojshme. Në qoftë se
14 ndonjëherë nuk ju kujtohet diçka dhe dëshironi që të
15 konsultoheni me këto dokumente për t'ju rifreskuar kujtesën,
16 ju lutem na e bëni me dije këtë gjë. Ju lutem keni parasysh që
17 një gjë të tillë duhet ta kërkonti vetëm atëherë në qoftë se
18 nuk ju kujtohet një gjë e caktuar. Nuk mund të lexoni në
19 mënyrë të drejtpërdrejt dokumentet.

20 Në qoftë se ju kërkoj që të mos flisni më, ju lutem
21 ndërprisni së foluri, po ashtu në qoftë se më shikoni që e
22 ngre dorën duhet ta ndërprisni së folurin. Kjo do të thotë që
23 më duhet t'ju jap udhëzime të mëtejshme.

24 Nëse e shikoni të arsyeshme që doni të bëni pushime, në
25 çdo pikë, ju lutem na e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 12

1 organizimet përkatëse.

2 Së fundi, për procesverbal ne themi që ju jeni i
3 shoqëruar sot nga zëvendëssoficeri ligjor i Ambasadës Amerikane
4 në Hagë. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues ka dhënë një urdhër
5 paraparak në lidhje me dëshminë tuaj që duhet që të jetë e
6 kufizuar me pika të caktuara gjatë dëshmisë përpara Trupit
7 Gjykues.

8 A i kuptoni të gjitha këto, Dëshmitar?

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, i kuptoj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
11 fillojmë me pyetjet e Prokurorit, që është ulur në të majtën
12 tuaj.

13 Z. Ferdinandusse, e keni ju fjalën.

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
15 Gjykatës.

16 Pyetje nga z. Ferdinandusse:

17 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim]

18 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Jemi takuar më herët, megjithatë
19 për procesverbal unë quhem Ward Ferdinandusse dhe unë jam
20 personi që do t'ju bëj pyetje sot nga Prokuroria. A më dëgjoni
21 mirë?

22 PË. Po, ju dëgjoj mirë. Faleminderit.

23 PY. A më thoni si quheni?

24 PË. Quhem Shaun Byrnes.

25 PY. Kur keni lindur?

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 13

1 PË. Kam lindur më 9 mars 1943.

2 PY. Çfarë shtetësie keni?

3 PË. Jam amerikan.

4 PY. Zotëri, a keni dhënë një dëshmi për Zyrën e Prokurorit të
5 Specializuar që e keni nënshkruar në shkurt të vitit 2020?

6 PË. Ju lutem, ma thoni edhe një herë?

7 PY. A keni dhënë dëshmi për ZPS-në që e keni nënshkruar në
8 2020?

9 PË. Këtë vit e keni fjalën?

10 PË. Jo, e kam fjalën për dëshminë që keni dhënë në 2020, që e
11 keni lexuar dhe njëherë përpara sesa të vinit këtu dhe që e
12 diskutuam edhe javën e kaluar.

13 PË. Po.

14 PY. Në rregull.

15 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës, do
16 ju lutesha që të paraqisnit në ekran dokumentin 05522 në
17 versionin në anglisht edhe dokumentin 05522 në shqip. Dy faqet
18 e para të këtij dokumenti, ju lutem. Ju kërkoj ndjesë, e
19 dhashë referencën e gabuar, dokumenti e ka numrin 075522. Edhe
20 versionin në shqip, ju lutem.

21 PY. A e keni parë më përpara këtë dokument, e njihni këtë
22 dokument, z. Dëshmitar, është procesverbali i intervistës që
23 keni pasur me Zyrën e Prokurorisë së Specializuar?

24 PË. Po, e kam parë më përpara.

25 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Le të shkojmë në faqen e

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 14

1 fundit të dokumentit në anglisht.

2 PY. A është nënshkrimi juaj ky, Dëshmitar?

3 PË. Po, është.

4 PY. A keni pasur mundësi që ta rishikoni këtë dokument
5 përpara sesa të nënshkruanit atëherë kur e keni dhënë
6 deklaratën?

7 PË. Po.

8 PY. A keni pasur mundësi që ta rishikoni këtë deklaratë dhe
9 një javë më përpara?

10 PË. Po.

11 PY. A jeni takuar me mua dhe kolegët e mi përpara një jave?

12 PË. Po.

13 PY. Në atë takim a ju janë dhënë mundësi që të bëni sqarime
14 dhe korrigjime lidhur me këtë dokument?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe, në fakt, a bëtë korrigjime dhe sqarime ju lidhur me
17 këtë dokument?

18 PË. Po.

19 PY. A ju kujtohet që sqarimet dhe korrigjimet që bëtë u
20 reflektuan në një shënim përgatitor që më pas ju lexua juve i
21 plotë?

22 PË. Po.

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Nuk është e nevojshme që ta
24 paraqesim në ekran shënimin përgatitor, megjithatë për
25 procesverbal dokumenti është 120244 deri në 120247.

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 15

1 PY. Duke marrë parasysh korrigjimet dhe sqarimet që keni
2 dhënë përpara një jave dhe që ne i kemi pasqyruar në shënimin
3 që përmenda më herët, informacioni i dhënë në deklaratën e
4 ZPS-së, a është i saktë dhe i vërtetë me aq sa ju dini dhe
5 besoni?

6 PË. Po.

7 PY. Duke marrë parasysh këto korrigjime, informacioni që keni
8 dhënë në deklaratën e ZPS-së a pasqyron në mënyrë të saktë atë
9 çfarë ju do të thonit në qoftë se do të pyeteshit përsëri për
10 të njëjtat pyetje?

11 PË. Po.

12 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani
13 dua që të kalojmë tek deklaratat e dëshmitar të ZPS-së.
14 Dokumenti me ERN 075522 deri në 075551 së bashku me versionin
15 në shqip dhe provat materiale të lidhura me to që janë pranuar
16 në mënyrë të përkohshme nga Gjykata në parashtrimin e
17 protokolluar F01848 dhe poshtëshënimet 155 deri në 159 të
18 këtij parashtrimi të protokolluar.

19 Dhe vërej që këto janë tri prova materiale shoqëruese,
20 versionet më pak të redaktuara ose versione më mirë të
21 lexueshme të cilat janë nxjerrë. Janë versione të cilat unë do
22 kërkoja që Trupi Gjykses t'i pranojë si prova materiale tani.
23 Në qoftë se është e nevojshme, mund t'i kaloj njëra pas
24 tjetrës, mund t'i them edhe njëherë të plota këto dokumente.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është e

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 16

1 nevojshme.

2 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po ashtu kërkoj që të
3 pranohet si provë materiale Shënimi Përgatitor 1, ERN 120244
4 deri në 120247 për t'u pranuar si provë materiale.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
6 kundërshtim nga Ekipet e Mbrojtjes.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi asnjë kundërshtim tjetër
8 përveç atyre që ua kemi bërë me dije deri tani.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

13 Dokumenti 075522 në versionet në shqip dhe në anglisht
14 pranohet si provë materiale. Shënimi Përgatitor 120244 dhe
15 120247 pranohet si provë materiale. Provat materiale
16 shoqëruese të renditura në dokumentin 50148 po ashtu pranohen.
17 Lidhur me numra që do t'i caktohen është shumë voluminoze si
18 kërkesë, kështu që Sekretarja e Seancës do caktojë numrat dhe
19 do na sqarojë sa i takon numrave përkatës, por jo tani.

20 Znj. Sekretare e Seancës kur do jetë e mundur që ta bëni
21 këtë gjë?

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
23 ndoshta për pak minuta do i caktojmë numrat përkatës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
25 vazhdoni, z. Ferdinandusse.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Page 17

1 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
2 Gjykatës.

3 Më datë 14 mars, ZPS-ja ka dorëzuar një përmbledhje të
4 propozuar për sa i takon këtij dëshmitari. Nuk kemi marrë
5 asnjë kundërshtim lidhur me këtë përmbledhje të propozuar,
6 Kështu që në qoftë se do më jepni leje, dua që ta lexoj këtë
7 përmbledhje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
9 vazhdoni.

10 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Nga gushti i vitit 1998 deri
11 në korrik 1999, Shaun Byrnes ishte shefi i Misionit Diplomatik
12 Vëzhgues në Kosovë në emër të Shteteve të Bashkuara, quajtur
13 ndryshe KDOM-i i Shteteve të Bashkuara. Në këtë rol, ai ka
14 ndërhyrë, ka ndërvepruar dhe ka marrë informacion nga figura
15 drejtuese të UÇK-së, përfshirë këtu edhe Shtabin e
16 Përgjithshëm, ushtrinë serbe dhe liderët politikë, anëtarë të
17 LDK-së dhe parti të tjera politike në Kosovë.

18 Byrnes ka marrë pjesë në komunikime të ndryshme në takime
19 dhe negociata të UÇK-së, përfshirë këtu dhe kontaktet me Jakup
20 Krasniqin, Hashim Thaçin, Rexhep Selimin dhe anëtarë të tjerë
21 të Shtabit të Përgjithshëm. Në këto kontakte, Byrnes ka takuar
22 shumë herë autoritete të ndryshme të UÇK-së dhe ka ngritur
23 pyetje që kanë të bëjnë me rrëmbimet ose me ndalimet nga
24 anëtarë të UÇK-së. Ai ka vënë re se liderët e UÇK-së janë
25 përpjekur që të fshehin informacion sa i takon strukturës së

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 18

1 komandës dhe operacioneve të UÇK-së.

2 PY. Z. Dëshmitar, do të vazhdojmë me pyetje që kanë të bëjnë
3 me rendin tuaj të ditës ose me agjendën që keni pasur në vitet
4 1998 dhe 1999.

5 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së
6 seancës që të paraqesë dokumentin 120248 nga Shënimi
7 Përgatitor numër 2. Pyetjet do jenë pyetje plotësuese dhe do
8 kenë të bëjnë me tema të ndryshme. Do ju kërkoja që të
9 dëgjoni pyetjet e mia, Dëshmitar dhe pastaj t'i përgjigjeni
10 pyetjeve vetëm me informacionin e nevojshëm, pra, dëgjoni
11 pyetjet dhe jepni përgjigjet përkatëse.

12 Dokumenti mban numrin 78 në listën e dokumenteve të
13 Prokurorisë. Do ju kërkoja që të kalonim tek dy faqet e fundit
14 të këtij dokumenti që janë faqet 120261 dhe 120262, ju lutem
15 paraqiteni krahe për krahe këto dy faqe, në versionin anglisht
16 dhe në shqip domethënë. Mbase do ishte më mirë që t'i
17 ndryshojmë radhën në mënyrë të tillë që të kemi në fillim
18 versionin përkatës.

19 PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që ju kërkoja që të lexonit
20 disa shënime që kishin të bënin me agjendën tuaj javën e
21 shkuar?

22 PË. Po.

23 PY. A i lexuat ato shënime të përfshira në pyetjet tuaja?

24 PË. Po.

25 PY. A e lexuat shënimin dhe përgjigjet përkatëse në agjendë?

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 19

1 PË. Po.

2 PY. Dëshmitar, shënimin që keni bërë në agjendë për dhjetorin
3 e 1998, që është në majtë sipër, përmend Dragobilin dhe emrin
4 Krasniqi, Buja, Bashota, është edhe Larry Rossin. A ka qenë
5 vërtetë një takim në 22 dhjetor të 1998?

6 PË. Po.

7 PY. Shihni në të djathtë poshtë, për 19 qershor 1999, ju
8 përmendni:

9 "10:30, mtg me UÇK-në, GHQ, Thaçi, Çeku ..."

10 Dhe ky reflekton një takim ku keni qenë ju i pranishëm?

11 PË. Po.

12 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, agjenda
13 është një provë materiale e pranuar me të gjitha faqet
14 përkatëse edhe faqja përkatëse e këtij materiali, ERN
15 përkatëse domethënë, është 1179771 deri në 11982222. Unë
16 sugjeroj që të mos i ripërsërisim të gjitha përgjigjet që
17 përmban kjo agjendë, por vetëm nëse lind nevoja nga avokatët
18 përndryshe le t'i pranojmë këto dy faqe si prova.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A thatë që
20 është pranuar?

21 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Agjenda po është pranuar si
22 provë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
24 çaktivizuar]

25 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Jo, e kisha fjalën vetëm për

1 këto dy faqet që kanë përgjigjet e dëshmitarit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

3 A ka ndonjë kundërshtim?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Më jepni një çast, ju lutem.

5 [Mbrojtja këshillohet]

6 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës,
7 parimisht nuk kam kundërshtim. Por dua të them për
8 procesverbal që janë bërë disa korrigjime në agjendë të cilat
9 gjenden në këtë shënim, të cilat mund të jenë relevante për
10 kundërpyetjet e mia. Por në dokumentin që po shohim ne në
11 ekran të paktën, nuk është bërë një sqarim apo të jetë bërë më
12 e qartë diçka. Thjesht është ndryshuar shqiptimi i një emri që
13 mund të jetë relevant.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
15 trajtoni këtë në kundërpyetjet e tuaja. Nuk ka asnjë problem.

16 Ka ndonjë kundërshtim tjetër? Z. Ellis?

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Atëherë materiali me numër 119771-119822 pranohet dhe merr
20 numrin e provës materiale.

21 [Trupit Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
22 këshillohen]

23 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase
24 duhet të shohim edhe një herë numrin për këto faqe, numrat
25 përkatës janë 120261 dhe 120262.

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 21

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt edhe ne kundërshtimin e
2 kemi për shtojcën, nuk e kemi kundërshtimin për Shënimin
3 Përgatitor numër 2. Këtë thjesht doja ta thoja për
4 procesverbal.

5 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Dhe në fakt, unë këto dy
6 faqe kërkoj që të pranohen si prova gjyqësore vetëm.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
8 çaktivizuar].

9 Më falni, atëherë e dhashë unë gabim numrin. Megjithatë,
10 përmbledhja pranohet, përmbledhja me dy faqe.

11 Prisni se ende s'i kemi dhënë numrin përkatës.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 faqet me numër 120261 dhe 120262 nga Shënimi Përgatitor numër
14 2 me ERN 120248 deri në 12262 marrin numrin e provës materiale
15 P1089 dhe është e klasifikuar si konfidencial.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Vazhdoni, z. Ferdinandusse.

18 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, tani do t'ju bëj disa pyetje që keni pasur më
20 22 dhjetor të 1998 me z. Rossin dhe me z. Krasniqi dhe me të
21 tjerë. Larry Rossin a ka qenë diplomat i Shteteve të Bashkuara
22 të Amerikës?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit. Do t'ju tregoj një video të shkurtër në
25 ekran.

1 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I lutem Sekretares së
2 Gjykatës që të nxjerrë nga provat e Prokurorisë videon me
3 numër 842, përndryshe ka ERN 06142705. Do lutesha që përkrahë
4 transkriptit në gjuhën angleze që mban numrin 842-ET, të
5 shfaqnim edhe videon.

6 Shkojmë më poshtë te transkripti, ju lutem. Në rregull.
7 PY. Z. Dëshmitar, në të djathtë në transkript në fund, do të
8 shihni që thotë:

9 "Diplomati i dytë: Është Ramë Buja".

10 "Diplomati i parë: Është kënaqësi që takohemi. E kam
11 takuar vëllain tuaj në Gjenevë".

12 Do ju lutesha të na identifikoni kush janë personat që i
13 kanë përmendur këto dy rreshta.

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Është minutazhi 2:40 deri në
15 2:56. Ndalojmë te 2:56, po duhet të fillojmë tek 02:40.

16 PY. Po përpara se të fillojmë, a i njihni këta persona?

17 PË. Po. Në të majtë është Larry Rossin që ka qenë drejtori
18 për Zyrën e Çështjeve të Evropës Juglindore në Departamentin e
19 Shtetit. Ndërsa në të majtë është Jakup Krasniqi që ka qenë
20 zëdhënës i UÇK-së.

21 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

22 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Do lutesha të shkonim tek
23 sekonda e 16.

24 [Luhet videoincizimi]

25 "Diplomati i parë: Ky është Jakup Krasniqi. Ky është Ramë

1 Buja.

2 "Diplomati i parë: E kam takuar vëllain tuaj në Gjenevë".

3 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ndaloni këtu.

4 PY. Dëshmitar, z. Rossin është ai që tha "Kam takuar vëllain
5 tuaj në Gjenevë"?

6 PË. Nuk e dalloj dot nga videoja. Më vjen keq.

7 PY. Në rregull. Faleminderit. Po e patë veten tuaj në video?

8 PË. Po.

9 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Harrova të thoja që të
10 gjitha provat materiale që do të shfaqen mund të jenë edhe për
11 publikun dhe do ju njoftoj unë në rast se nuk duhet të jenë
12 publike.

13 PY. Dëshmitar, Larry Rossin a ju tha që kishte takuar
14 përfaqësues të UÇK-së përpara këtij takimi të 22 dhjetorit të
15 1998 në Kosovë?

16 PË. Nuk më kujtohet.

17 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
18 doja t'i rifreskoja kujtesën dëshmitarit dhe për këtë do të
19 doja që të shihnim Shënimin Përgatitor 2, paragrafin 26.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

21 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim]

22 PY. Javën e shkuar në pyetjen tonë ju u përgjigjët që

23 "Kishit dëgjuar për kontakt në Gjenevë nga Larry Rossin,
24 që donte të takohej me udhëheqësit e UÇK-së. Gjatë një vizite
25 të mëpasshme në Dragobil më tregoi që kishte takuar UÇK-në në

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 24

1 Gjenevë. Nuk më tregoi gjë për hollësitë aso kohe. Po më tha
2 që kishte kontaktuar me Bardhi Mahmutin”.

3 Dëshmitar, a ju rifreskon kujtesën kjo?

4 PË. Po.

5 PY. A është e saktë?

6 PË. Po.

7 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Do të doja të shihnim një
8 dokument që është sekuestruar nga shtëpia e Jakup Krasniqit
9 dhe përmend një takim me z. Rossin në Gjenevë në vitin 1998.

10 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I lutem Sekretares së
11 Gjykatës që të vendosë në ekran dokumentin me SPOE00221639 në
12 gjuhën angleze.

13 PY. Dëshmitar, sikurse e shihni në këtë dokument në krye
14 thuhet:

15 “Takim me z. Lawrence Rossin, Drejtor për Evropën
16 Juglindore në Departamentin e Shtetit të SHBA-së”.

17 Në paragrafin e dytë thuhet:

18 “Fillimisht z. Rossin falënderoi delegacionin tonë,
19 përfshirë Bardhyl Mahmutin, Ramadan Avdiun, Bilal Sherifin dhe
20 Agush Bujën dhe shprehu mirënjohjen e tij për gatishmërinë për
21 të na takuar dhe për të shkëmbyer ide sa i takon situatës
22 politike dhe të sigurisë në Kosovë”.

23 Dëshmitar, e keni parë ndonjëherë këtë dokument përpara
24 javës së shkuar?

25 PË. Jo, e pashë javën e shkuar kur u takuam bashkë.

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 25

1 PY. Po a përputhet kjo me atë që ka thënë z. Rossin që ka
2 takuar përfaqësues në Gjenevë?

3 PË. Nga sa më kujtohet mua, z. Rossin në një moment më ka
4 thënë që ishte takuar me përfaqësues të UÇK-së në Gjenevë. Por
5 unë dhe Larry folëm shpesh, bisedonim shpesh në telefon kur
6 ishte në Uashington dhe nuk më kujtohet konkretisht kur ma ka
7 thënë konkretisht se kur ishte takuar me përfaqësues të UÇK-së
8 në Gjenevë, a ka qenë para a pas takimit të dhjetorit të 1998.

9 PY. E kuptoj. Faleminderit, Dëshmitar.

10 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I të nderuar Gjykatës,
11 kërkoj që të pranohet ky dokument që mban numrin SPOE00226139
12 dhe SPOE00226144, si në shqip dhe në anglisht. Është dokument
13 i sekuestruar nga shtëpia e Jakup Krasniqit në Prishtinë në
14 nëntor të vitit 2020. Vërej për procesverbal që këtu përmenden
15 emrat e personave që kanë marrë pjesë dhe në faqen e fundit
16 emri i personit që e ka përgatitur këtë dokument.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Kundërshtojmë, si zakonisht,
18 përdorimi i dokumenteve që janë sekuestruar nga shtëpia e
19 Jakup Krasniqit, po ashtu e vetmja pjesë e dokumentit që i
20 është treguar dëshmitarit është një paragraf ku flitet për
21 personat që kanë qenë të pranishëm në takim, dëshmitari na
22 konfirmoi. Nuk ka asnjë vlerë të shtuar në këtë pikë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni të
24 kundërpërgjigjeni?

25 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit. Dëshmitari na

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 26

1 tregoi kontekstin e këtij dokumenti duke na konfirmuar se z.
2 Rossin i ka konfirmuar se ka pasë një takim të tillë. Ne e
3 pyetëm a i kujtohen detale edhe ai tha që jo. Kështu që unë
4 mendoj se sidoqoftë kjo beson që të pranohet dokumenti në
5 provat gjyqësore.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Dokumenti SPOE00226139 në anglisht dhe SPOE00226144 pranohet
8 si pjesë plotësuese e seksionit 138.

9 Vazhdoni.

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 dokumenti me ERN SPOE00226139 deri në SPOE00226144 dhe
12 përkthimi në gjuhën angleze pranohen dhe marrin numrin e
13 provës materiale P01090 dhe janë të klasifikuara si
14 konfidenciale.

15 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Duhet të kisha thënë pak më
16 herët. Që të gjitha materialet që po kërkoj të pranohen
17 gjyqësore mund të klasifikohen si publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. I
19 riklasifikojmë si publike.

20 Mund të vazhdoni.

21 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Dëshmitar, tani do të ndryshojmë temën dhe do të doja
23 t'ju pyesja për arrestimin që u ka bërë UÇK-ja dy zyrtarëve të
24 LDK-së më 30 tetor, të cilët u liruan më 27 nëntor të vitit
25 1998.

1 Në deklaratën që na keni dhënë ju keni thënë dhe unë po
2 citoj nga paragrafi 117:

3 "Më kujtohen që këto dy personat u mbajtën të ndaluar
4 diku mes Malishevës dhe Kievës dhe mësuam për 'arrestimin' e
5 tyre nga përfaqësues të LDK-së. Pas kësaj, kontaktua trojkën
6 dhe u kërkua informacione për rrëmbimin. Bardhyl Mahmuti na
7 tha se ata ishin 'arrestuar' se kishin bashkëpunuar me
8 policinë serbe dhe kishin inkurajuar vendasit që të dorëzonin
9 armët. Dhe po ashtu na thanë se ishin 'trajtuar mirë' dhe se
10 mund të zgjidhnin avokatë për t'i përfaqësuar në 'gjykim'. Ne
11 ishim skeptikë për këto që na thanë".

12 A ju kujtohet kujt ia ka thënë këto fjalë z. Mahmuti?
13 PË. Nëse e kuptova unë siç duhet pyetjen tuaj, ai m'i ka
14 thënë mua këto. A është kështu?

15 PY. Pyetja ime është kujt ia ka thënë Bardhyl Mahmuti këto
16 fjalë, a ishit ju apo ishte një person tjetër, përgjigja juaj?

17 PË. Mua m'i ka thënë. Po a mund të bëj një korigjim të
18 vogël?

19 PË. Po.

20 PY. Z. Mahmuti nuk ka qenë anëtar i trojkës. Trojka kishte
21 Jakup Krasniqin, Sokol Bashotën dhe Ramë Bujën, të cilët i
22 kishim thirrur në telefon kur mësuam nga LDK-ja për rrëmbimin
23 e këtyre dy anëtarëve të LDK-së jashtë Prishtinës. Z. Mahmuti,
24 mesa kam kuptuar unë, ka qenë në Gjenevë, ka qenë personi i
25 kontaktit kur donim të siguroheshim që trojka dhe eprorët e

1 kuptonin që ishim vërtetë të interesuar për të zgjidhur një
2 aspekt të caktuar.

3 PY. Faleminderit. Z. Mahmuti t'i ka thënë personalisht apo
4 përmes telefonit këto gjëra?

5 PË. Përmes telefonit.

6 PY. A ju kujtohet kush i bëri i pari thirrjen telefonike?

7 PË. Unë.

8 PY. A keni pasur kontakte me persona të tjerë që kishin
9 mbiemrin Mahmuti në vitin 1998 apo vetëm me Bardhyl Mahmutin?

10 PË. A mund ta përsërisni pyetjen?

11 PY. Po. A keni pas kontakte me persona të tjerë që kishin
12 mbiemrin Mahmuti apo keni pas kontakte vetëm me Bardhyl
13 Mahmutin?

14 PË. Vetëm me Bardhylin.

15 PY. Faleminderit. Dëshmitar, Do ndryshojmë sërish temë dhe
16 tani do t'ju bëj disa pyetje për mbajtjen e ndalimit të disa
17 politikanëve në Qirez në shtator të 1998.

18 Në deklaratën tuaj, thoni dhe po citoj nga paragrafi 108:

19 "Kur fola me Dedaj pas lirimit të tij më tha se anëtarë
20 të grupit i rrahu Sabit Geci. Po tha që Hashim Thaçi ka qenë
21 përgjegjës, po personalisht nuk kishte rrahur askënd. Dedaj
22 ishte këmbëngulës që unë të mos flisja për përfshirjen e UÇK-
23 së prandaj dhe unë nuk fola publikisht për këtë".

24 Sa kohë pas lirimit të tha z. Dedaj që disa anëtarë të
25 grupit i kishin rrahur?

1 PË. Nuk më kujtohet saktësisht periudha kohore, po ka qenë
2 shumë shpejt pas lirimit të tij. Mbase një a dy ditë më pas.

3 PY. Faleminderit. Sa kohë pas lirimit të tha z. Dedaj që z.
4 Thaçi ka qenë përgjegjës por që personalisht nuk kishte rrahur
5 askënd?

6 PË. Në të njëjtën kohë kur folëm për këtë gjë. Pas lirimit të
7 tij.

8 PY. Keni pas vetëm një takim me të?

9 PË. Me sa kujtoj unë, po.

10 PY. Faleminderit. A ju kujtohet kush që nismëtar i kësaj
11 bisede?

12 PË. Unë.

13 PY. A ju kujtohet pse e kërkuat ju ta bënit këtë takim?

14 PË. Po. Unë dhe Departamenti i Shtetit deshëm të mësonim
15 lidhur me rrethanat e trajtimit të burgosurve gjatë kohës që
16 ishin rrëmbyer.

17 PY. Faleminderit. Ju thatë që:

18 "Dedaj ishte këmbëngulës, ngulte këmbë që unë të mos
19 flisja për përfshirjen e UÇK-së ...".

20 A ju kujtohet saktësisht se çfarë ju ka thënë në lidhje
21 me këtë?

22 PË. Ma ka thënë po nuk i kujtoj fjalë për fjalë se çfarë më
23 ka thënë.

24 PY. Do të shohim një nga përgjigjet që na keni dhënë javën e
25 shkuar. Që është në materialin 120251, paragrafi 16:

1 "Kur ju pyetën cila është bazë që thoni ju që Dedaj
2 këmbëngulte që unë të mos nxirrja përfshirjen e UÇK-së.
3 Përgjigje: Dedaj më tha se kishte frikë se mos merrnin hak dhe
4 donte që ta linte UÇK-në jashtë kësaj publikisht".

5 Ju rifreskon kujtesën?

6 PË. Po. Është e saktë. Kështu më kujtohet dhe mua në
7 përgjithësi se çfarë ka thënë. Nuk mund të them që është fjalë
8 për fjalë kështu. Po në vija të përgjithshme kjo ka qenë ajo
9 që ka thënë ai.

10 PY. Faleminderit. A keni pasur më kontakte me Dedaj pa
11 shtatorit të 1998?

12 PË. Po.

13 PY. Thjesht sa për t'ju informuar, unë përpiqem të ngadalësoj
14 sepse më bënë koment nga përkthyesit që po flas shumë shpejt,
15 kështu që do të bëjmë disa pauza mes pyetjeve dhe përgjigjeve.

16 Z. Dedaj a ju ka dhënë ndonjëherë një version të ndryshëm
17 lidhur me ngjarjen krahasuar me atë që ju tha menjëherë pas
18 lirimit të tij?

19 PË. Jo.

20 PY. Në paragrafin 109 të deklaratës suaj, ju thoni dhe citoj:

21 "Kam folur dhe Agim Krasniqin, një nga të ndaluarit e
22 tjerë. Ai më tha se e kishte marrë në pyetje [Nuk ka
23 përkthim].

24 Sa kohë pas lirimit të tij ta tha Agim Krasniqi që e
25 kishin keqtrajtuar dhe se e kishte marrë në pyetje Thaçi?

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 31

1 PË. Pak pas disa ditësh, shpejt pas lirimit të tij.

2 PY. Faleminderit. A ju kujtohet kush e mori nismën për të
3 filluar këtë bisedë?

4 PË. Unë.

5 PY. E pse e nisët ju këtë bisedë?

6 PË. Sepse isha i interesuar të mësoja sesi ishin trajtuar të
7 ndaluarit dhe po aq i interesuar ishte Departamenti i Shtetit.

8 PY. Faleminderit. Do ndryshojmë sërish tema dhe do t'ju bëj
9 disa pyetje për takimet që keni pasur me Jakup Krasniqin dhe
10 të tjerët në fund të 1998 dhe në fillim, pra, në janar të
11 1999. Nuk do ju kërkoja të më përsërisni ato që na keni thënë
12 tashmë për këto takime, po dua t'ju tregoj disa dokumente dhe
13 t'ju bëj pyetje në lidhje me to.

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Dokumenti i parë është po
15 ashtu një dokument që e kemi sekuestruar nga shtëpia e Jakup
16 Krasniqit. Më falni, është një dokument që kemi sekuestruar
17 nga Jakup Krasniqi po jo nga shtëpia e tij.

18 Sekretare e Gjykatës, ju lutem vendosni në ekran
19 materialin me numër SPOE00231037 në gjuhën angleze. Dhe
20 shkojmë në faqen e parë për të orientuar dëshmitarin.

21 PY. Siç mund ta shihni thotë:

22 "Dr. Jakup Krasniqi".

23 Vijon më poshtë:

24 "Libri në përpunim.

25 "UÇK-ja në Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë për

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 32

1 Kosovën dhe bombardimet e NATO-s".

2 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Më pas, do të fokusohemi
3 tek faqet që mbajnë numrin SPOE00231057 deri në SPOE00231066.
4 Shkojmë më konkretisht tek faqja 1057.

5 PY. Diku sipër në faqe, paragrafi i dytë thotë:

6 "Takimi i dytë i paralajmëruar në mes të përfaqësuesve të
7 SHP-së të UÇK-së dhe Christopher Hill do të mbahet në selinë e
8 KDOM amerikan në fshatin Dragobil të Malishevës. Delegacioni
9 shqiptar udhëhiqej nga Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Ramë
10 Buja. Tema kryesore e bisedimeve ishte çështja e Kosovës sipas
11 dokumentit të ambasadorit C. Hill".

12 Pak më poshtë thuhet:

13 "Me theks të veçantë u bisedua për LDK-në".

14 Pak më poshtë, është një fjali diku poshtë faqes dhe
15 thotë dhe unë citoj:

16 "Roli ndërmjetësues nga ana amerikane ju caktua Shaun
17 Byrnes, që ishte përgjegjës i KDOM-it, që ishte një diplomat i
18 mirë dhe me të cilin kishim arritur të krijojmë raporte të
19 mira të ndërsjella".

20 Ju thatë që keni marrë pjesë në një takim me Hillin,
21 Thaçin dhe Krasniqin në Dragobil. Kjo është në paragrafin 69
22 dhe 70 të deklaratës suaj. Dokumenti i përgatitur nga
23 ambasadori Hill ka qenë objekt bisedimi në takim?

24 PË. Po.

25 PY. A ju kujtohet që keni folur dhe për LDK-në në fund të

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 33

1 1998 me Jakup Krasniqin?

2 PË. Jo, nuk më kujtohet.

3 PY. Edhe një herë do rifreskoj kujtesën tuaj dhe do ju tregoj
4 një përgjigje që keni dhënë javën e kaluar dhe kjo është e
5 pasqyruar në materialin 120254, paragrafi 30. Citoj:

6 "Jakup Krasniqi dhe të tjerë në Shtabin e Përgjithshëm të
7 UÇK-së ishin shumë kritikë ndaj LDK-së edhe kur bisedonin me
8 mua".

9 A ju rifreskon kujtesën?

10 PË. Po.

11 PY. Është korrekte?

12 PË. Po. Po duhet të shtoj diçka këtu.

13 PY. Po.

14 PË. Dokumenti në fjalë ka qenë një dokument, ishte i
15 papërpunuar, një version i papërfunduar që do të dorëzohej në
16 konferencën e Rambujesë lidhur me statusin e Kosovës në të
17 ardhmen. Unë nuk kam qenë pjesë për përgatitjen e këtij
18 dokumenti. Këtë dokument po e përgatiste Departamenti i
19 Shtetit, Zyra e Dr. Rossin dhe ambasadorit Hill, që ishte
20 ambasador i SHBA-së në Maqedoni që ishte caktuar, ishte edhe i
21 dërguari i posaçëm për Kosovën nga Sekretarja e Shtetit
22 Madeleine Albright.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju
25 lutem, 01058, shkojmë më poshtë.

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 34

1 PY. Do lexoj rreshtat e parë të paragrafit të fundit:

2 "Delegacioni, në përbërje të re, brenda një kohe të
3 shkurtër ka pasur dy takime, njërin me ambasadorin C. Hill dhe
4 tjetrin me Drejtorin e SDA-së për Evropën Juglindore z. Larry
5 Rossin i cili (pas lufte) është përfaqësues i Zyrës Amerikane
6 në Prishtinë ...".

7 Dëshmitar, a është e vërtetë që z. Rossin u bë
8 përfaqësues i Zyrës Amerikane në Prishtinë pas luftës në
9 Kosovë?

10 PË. Po. Në fakt, u bë drejtori i Zyrës së SHBA-së në
11 Prishtinë pasi u mbyll KDOM-i.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, ju
14 lutem.

15 PY. Do ju lexoj dy fjalitë e para. Citoj:

16 "Ne z. Hill i kemi dhënë vërejtjet tona në dokumentin e
17 tij më vonë në një variant të shkurtuar që ka qenë i botuar në
18 të përditshmen 'Koha Ditore'. Askush nuk ka pasur guxim që të
19 kryente një dokument të tillë".

20 A ju kujtohet që Shtabi i Përgjithshëm i ka dhënë
21 vërejtje Shtabit të Përgjithshëm [Sipas përkthimit] për këtë
22 dokument në fund të 1998?

23 PË. Po.

24 PY. A e kanë dhënë me shkrim?

25 PË. Nuk më kujtohet.

Dëshmitari: Shaun Byernes (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Ferdinandusse

Faqe 35

1 PY. Faleminderit. Do ju rifreskoj kujtesën me një përgjigje
2 që keni dhënë më përpara. Është paragrafi 129 Shënimi
3 Përgatitor 2. Thatë:

4 "Më kujtohet që Shtabi i Përgjithshëm ka dhënë qëndrimin
5 e vet me shkrim për dokumentin e z. Hill".

6 A ju rifreskon kjo kujtesën?

7 PË. Nuk më kujtohet të na kenë dhënë ndonjë dokument me
4 tek kjo pikë, është në datën 28 tetor.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të shfaqim datën 28, ju
6 lutem?

7 PY. Dhe këtu thuhet:

8 "U nisëm për Likovac

9 "Demaçi

10 "Takime.

11 "Varre

12 "Vend masakrash

13 "Thaçi".

14 E shihni këtë?

15 PË. Po.

16 PY. Pra, qëndrimi i z. Thaçi është që kjo është hera e parë
17 kur ju jeni takuar. Keni arsye që të mos bini dakord me këtë?

18 PË. Po. Me ç'mbaj mend unë, kjo nuk ka qenë hera e parë kur
19 ne jemi takuar.

20 PY. Kur ka qenë hera e parë kur jeni takuar?

21 PË. Nuk është se e kam kalendarin me vete, megjithatë ne jemi
22 takuar për herë të parë mendoj që ka qenë ose fundi i gushtit,
23 ose fillimi i shtatorit në -- Drenovc, Likovc. Dhe, z. Thaçi
24 nuk u identifikua në atë moment. Adem Demaçi më nxori që unë
25 të takoja pjesëtarë të UÇK-së, por ata nuk dhanë emrat e tyre,

1 pra nuk u identifikuan, madje as z. Demaçi nuk e bëri këtë
2 gjë, dhe pastaj pasi ishte bërë takimi me z. Thaçi, ne e
3 diskutuam dhe e kuptova që e kisha parë atë më parë.
4 PY. Në këtë ditë, ky pasqyrohet si hera e parë që ju e keni
5 takuar z. Thaçi. Mund t'i shohim edhe datat e mëparshme, por
6 unë mund t'ju parashtroj që kjo është hera e parë ku përmendet
7 z. Thaçi këtu.

8 Ndërsa, sa i takon përket z. Demaçi, në këtë ditë dhe
9 meqë ra fjali, meqenëse e kemi të paraqitur në ekran, është e
10 saktë që z. Demaçi ju ka prezantuar z. Thaçi, por po ta
11 shikoni ç'është shkruajtur këtu në datën 28 tetor, këtu keni
12 "Demaçi", shigjetë, "Thaçi".

13 PË. E saktë.

14 PY. Pra, ajo që sugjerohet është që z. Demaçi ju ka çuar që
15 ju të takoni Thaçin, apo jo?

16 PË. A mund të shtoj diçka? Z. Demaçi, në disa raste madje, më
17 ka çuar, më ka marrë për të më prezantuar udhëheqës të tjerë
18 të UÇK-së, për shembull komandant Remin, të zonës së Llapit,
19 ose më ka çuar në Jabllanicë në një moment të caktuar për t'u
20 takuar me Ramush Haradinajn, në zonën e Dukagjinit. Dhe, meqë
21 ra fjala, shkuam atje, por ai nuk ishte atje për takimin,
22 pavarësisht. Pra, kjo ishte. Nuk është se ishte e pazakontë si
23 rrethanë në vetvete.

24 PY. Okej.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë tani tek

1 muaji shtator, ju lutem.

2 PY. Përpara datës 28 tetor, këtu kemi vetëm dy shënime në dy
3 data për takimet tuaja me Adem Demaçin. Njëri është në datën 2
4 shtator, ndërsa tjetri në datën 21 shtator. Dhe nuk ka asnjë
5 informacion tjetër apo pjesëmarrës të tjerë në këtë takim.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaj ju lutem që të shfaqim në
7 ekran datën 2 shtator. Duhet të jetë faqja 11974 [Sipas
8 përkthimit]. Po.

9 PY. Pra, në mesditë, në datën 2 shtator, keni momentin e parë
10 kur është shkruajtur "Demaçi" dhe askush tjetër. Kur hytë në
11 Kosovë, në gusht, ju e dinit se kush ishte Adem Demaçi, apo
12 jo?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, nuk është se ju nuk e dinit se kush ishte Demaçi
15 deri në datën 2 shtator?

16 PË. Po.

17 PY. A ka ndonjë arsye se pse ju nuk do keni shkruajtur ndonjë
18 takim që keni pasur me Demaçin në gusht?

19 PË. Jo, jo. Në fakt jam, ndjehem pak i ngatërruar me pyetjen.
20 Jam dhe i paqartë.

21 PY. Po mirë, mund t'ju tregoj datën 2 shtator [Sipas
22 përkthimit] në faqen përkatëse, e cila ka numrin -- pra, në
23 fakt është 119777. Edhe këtu sërish, tek pjesa e mesditës
24 thuhet, "Adem Demaçi" dhe një orë më përpara në orën 11,
25 thuhet "Krasniqi LDK", dhe nuk i referoheni ndokujt tjetër.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 82

1 PË. Ka shumë të ngjarë që kjo ka qenë një telefonatë në atë
2 kohë, pra unë kam bërë telefonata nga zyra, kam thirrur
3 Demaçin për të folur për situatën.

4 PY. Të vetmet referenca të qarta që ju keni për Fatmir Limajn
5 janë në datën 31 gusht [Sipas përkthimit] dhe në datën 6
6 nëntor. Kur e keni kuptuar për herë të parë kush ishte Fatmir
7 Limaj?

8 PË. Ndoshta në atë kohë. Ajo që mbaj mend është që ne kemi
9 patur një takim të hershëm, të krijuar nga Demaçi, të
10 organizuar nga Demaçi, me ç'kuptoj unë nga fundi i gushtit dhe
11 fillimi i shtatorit, në të cilin ka qenë i pranishëm Fatmir
12 Limaj si dhe Shukri Buja që ka qenë komandant i zonës të
13 Nerodimës. Nuk e dija në atë kohë se kush ishin ata, ishte
14 thjesht që ishin oficerë të lartë në UÇK. Dhe më vonë,
15 sigurisht, oficerët e UÇK-së me të cilët ne kemi patur
16 kontakte, dhe unë kam filluar t'i njoh, kanë qenë më të hapur
17 për t'u identifikuar, pra, se kush ishin. Dhe a mund të shtoj
18 edhe një koment tjetër, ju lutem?

19 PY. Po.

20 PË. Unë kam shërbyer në ushtri kështu që arrija të vlerësoja
21 shqetësimet që kishte UÇK-ja për sigurinë, për çështjet e
22 sigurisë. Ne kishim përkthyes nga të dyja këto nënshtetësi,
23 kryesisht shqiptarë, por kishim edhe pak serbë me vete. Dhe
24 ajo që mendoja unë në ato momente ishte që të dy këto grupe
25 nënshtetësish, shtetasish, ishin ndoshta, ndoshta, po

1 raportonin për ne, shqiptarët, dhe shumica më saktë e
2 përkthyesve tanë shqiptarë ishin studentë të rinj që flisnin
3 një anglishte të shkëlqyer. Dhe në disa raste ishin ende duke
4 studiuar në universitetin e Prishtinës dhe sigurisht që kishin
5 ndjesi shumë të afërt me UÇK-në. Dhe mendoj që ishte e drejtë
6 që ata që po t'u kërkonim përfaqësuesve të UÇK-së për shembull
7 që kush kanë qenë të, që kanë qenë të pranishëm në Prishtinë,
8 ata të flisnin për shembull për, sidomos për sjelljen ose për
9 sjelljen e KDOM-it ose të SHBA-së. Pra, mendoj që ky prezumim
10 ishte shumë i saktë, dhe mund ta them, siç e themi ne në
11 Amerikë, domethënë unë kisha përvojën time, kështu që nga kjo
12 përvojë më nxirrte në këtë përfundim.

13 Dhe mbi të gjitha ne kishim edhe përkthyes serbë të cilët
14 flisnin shqip, dhe duke patur parasysh natyrën e regjimit
15 shtypës serb, unë nuk kisha kurrfarë dyshimi që policia serbe
16 po i shtynte këta persona herë pas here në formë periodike që
17 të merrnin informacion për ne, për mendimet tona, çfarë
18 qëndrimesh kishim ne si për Serbinë, për serbët, ashtu edhe
19 për UÇK-në.

20 Dhe besoj, po të isha unë, për shembull, oficer i UÇK-së
21 dhe ta dija që kishim përkthyes serbë që punonin për ne,
22 amerikanët, unë do të kisha pasur tmerrësisht kujdes për
23 çfarëdolloj gjëje që do të diskutoja me mua në këtë rast, apo
24 me zëvendësat e mi, lidhja me, për shembull, me personalitetet
25 në UÇK, me strukturën e UÇK-së, apo me, për shembull, të

1 plagosur të UÇK-së, viktima, apo vendndodhje të UÇK-së. Pra
2 ata vetë mund të kishin besim tek ne, por po të kishim të
3 pranishëm përkthyes serbë...

4 PY. Kjo procedurë, sa kohë ka zgjatur ku ju keni patur
5 përkthyes serbë në takime?

6 PË. Gjatë të gjithë periudhës që ishte KDOM-i atje dhe
7 funksiononte.

8 PY. Pra, kur ju bënë pyetje më parë që UÇK-ja përpiquej që të
9 ishte sekrete në lidhje domethënë me strukturën e vet, ju po
10 thoni që kjo ka qenë për arsye të përkthyesve serbë?

11 PË. Po. Se ka kuptim, është e logjikshme kjo gjë.

12 PY. Ju thatë që e mbani mend që, e mësuat që kush ishte z.
13 Limaj, në tetor më duket thatë?

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj, Gjykatës. A
15 mund të jemi pak më të qartë për kur mësuat se kush ishte
16 personi? Se kjo mund të interpretohet në forma të ndryshme.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem të
18 jeni më të qartë në pyetjen tuaj.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt këtë pyetje bëra dhe më
20 parë, dhe nuk pati ndonjë kundërshtim, dhe madje mund të them
21 që është në faqen 73, në rreshtat 7 dhe 8, dhe përgjigjja
22 ishte, që:

23 "Po, në atë kohë".

24 Kështu që e kemi vënë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, pra nuk

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 85

1 është e nevojshme ta bëni pyetjen dhe një herë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Thjesht për të rifreskuar kujtesën
3 e dëshmitarit.

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Unë pranoj që ndoshta nuk u
5 tregova shumë i shpejtë, por pyetja "kuptuat se kush ishte"
6 është në fakt një pyetje që mund të interpretohet në disa
7 forma...

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
9 kundërshtimi juaj.

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Pra, a mund të themi që ju e mësuat se kush ishte ai në
12 fund të tetorit, në fillim të nëntorit?

13 PË. Besoj, mendoj, se po. Por nuk është se e kam në kujtesë
14 të qartë këtë gjë. Pra, nuk e kam mësuar se kush ishte ai, pra
15 identitetin e tij që herën e parë që e kam takuar, kështu e
16 mbaj mend të paktën, më vjen keq në rast se nuk ju përgjigjem
17 kaq qartazi.

18 PY. Jo, po se jemi 25 vjet më pas, por kur e mësuat se kush
19 ishte z. Thaçi, identitetin e tij?

20 PË. T'ju them të drejtën, mund ta marr me mend se z. Thaçi,
21 dhe më lejoni të shtoni, që me ç'kam kuptuar unë në atë kohë,
22 z. Thaçi u largua nga Kosova për të punuar në Evropën
23 Perëndimore dikur në, ndoshta mes nëntori.

24 PY. Po, por besoj që ju e njihnit më përpara, se jeni takuar
25 me të më parë.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 86

1 PË. Po, përpara se të largohesh, unë në atë moment e kam ditur
2 kush ishte ai, dhe e njihja atë. Pra, e kuptoja se kush ishte.

3 PY. Po ju nuk e mbani mend nëse e keni kuptuar se kush ishte
4 ai, identitetin e tij, në fillim të tetorit, për shembull?

5 PË. Jo.

6 PY. Okej. Më lejoni pak të flas edhe për disa takime që keni
7 patur dhe në rast se keni dëshirë që të kalojmë tek ditari
8 juaj, më thoni, se e shfaqim atë në ekran.

9 PË. Jo, s'ka gjë, e kuptoj.

10 PY. Ju thoni që jeni takuar me z. Thaçi së pari më 31 tetor
11 me z. Fatmir Limaj për të folur për personat e zhvendosur,
12 është e saktë kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe jeni takuar me të sërish në datën 6 nëntor për të
15 diskutuar përgatitjet e takimit të tij me Christopher Hill,
16 ditën më pas. Është e saktë kjo?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe u diskutua kjo nga Prokurori, jeni takuar me të në 6
19 nëntor në Dragobil, me Christopher Hill, Jakup Krasniqin dhe
20 Ramë Bujën?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe ju konfirmuat që u takuat me z. Thaçi më 12 nëntor të
23 vitit 1998, synimi, objektivi i këtij takim ka qenë që ju t'ia
24 prezantonit ambasadorit William Walker, është e saktë kjo?

25 PË. Po.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 87

1 PY. Në intervistën tuaj me ZPS-në, në faqen 16 të saj -- që
2 do të thotë që ajo ka numrin P01066, në faqen 16, paragrafi
3 71, ju thoni:

4 "Unë mendoj që zyrtarët e KDOM-it amerikan e kanë takuar
5 z. Thaçi në më pak se pesë raste."

6 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj, i nderuar
7 Gjykatës, sepse ajo pjesë është korrigjuar në Shënimin
8 Përgatitor numër 1.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të na tregoni pak më qartë
10 se ku mund ta gjejmë atë?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po lexoni nga
12 ai shënim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo nga shënimi, por nga deklarata.

14 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] I referohem dokumentit numër
15 120247, paragrafi 50. Mund dhe t'jua lexoj, nëse preferoni.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, s'ka gjë. E kuptuam, e kemi
17 përpara.

18 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Në rregull.

19 Z. MISETIC: [Përkthim]

20 PY. Atëherë, ajo që shikojmë në kalendarin tuaj është që ju
21 jeni takuar me të me, emrin e tij pra e keni shënuar pesë
22 herë.

23 PË. Në fakt nuk ju dëgjova mirë, a mund ta përsërisni
24 pyetjen?

25 PY. Po tani më dëgjoni?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 88

1 PË. Nuk e di pse kam vështirësi, nuk ju dëgjoj fort mirë. Të
2 përpigemi sërish, por papritur e pa kujtuar nuk kisha më, nuk
3 e dëgjoja më.

4 PY. Në fakt ndonjëherë edhe ulet volumi në bazë të
5 mikrofonave, të numrit të mikrofonave që janë ndezur në të
6 njëjtën kohë në sallë.

7 Nuk jeni dakord me mua që në kalendarin tuaj janë
8 pasqyruar pesë takime me z. Thaçi, të shënuara me emër?

9 PË. Në fakt do më duket që ta kem përpara që t'ju them. Është
10 e vështirë për mua që të përgjigjem.

11 PY. Unë ju fola për të gjitha takimet që janë pasqyruar në
12 ditarin tuaj dhe janë pesë me emrin e tij.

13 PË. Po unë nuk i numërova ama.

14 PY. Atëherë, ndjesia juaj për rolin e z. Thaçi në UÇK u
15 formua në bazë të takimeve që ju keni patur me të në fund të
16 tetorit, dhe fillim të nëntorit. Është e saktë kjo?

17 PË. Ndjesitë e para, apo perceptimet e para që pata.

18 PY. Po, të themi në 1998 pastaj pas Rambujesë është gjë
19 tjetër.

20 PË. Po.

21 PY. [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 Është e saktë kjo?

3 PË. Po, zotëri.

4 PY. Ju e thatë me theks, "Po, zotëri", e theksuat "zotëri".

5 PË. Po, ashtu e thashë. Është e saktë.

6 PY. Pra thjesht dua t'ju pyes, këta personat që ishin me z.

7 Thaçi dhe në takimet që keni patur me të që i drejtoheshin

8 atij dhe i merrnin, si me thënë, atij mendimin, kjo nuk do të

9 thotë domosdoshmërisht që ata ju merrnin mendime për çështje

10 ushtarake, apo jo? Jeni dakord me këtë fjali timen?

11 PË. Nuk -- po, sepse diskutimet, ato diskutime nuk kanë qenë

12 përgjithësisht ose unë do t'i përshkruaja -- më falni për

13 kollën -- nuk kanë qenë përgjithësisht për çështje ushtarake.

14 Por kanë pasur të bëjnë me armëpushim, me lirim të pengjeve,

15 ose me organizimin e takimeve për ambasadorin Hill, këto lloj

16 gjërash.

17 PY. Mos keni nevojë për ujë?

18 PË. Jo, faleminderit.

19 PY. Në takim -- në përgjigjet që i keni dhënë Prokurorit

20 javën e shkuar keni përdorur një gjë interesante. Ku thoni që

21 Shtabi i Përgjithshëm ka qenë si ministria e jashtme e UÇK-së.

22 Është e saktë kjo?

23 PË. Po, kjo ka qenë ndjesia që kemi marrë ne. Mendimi që kemi

24 patur.

25 PY. Dhe kjo ka qenë për arsye se në emër të UÇK-së ata po

1 merreshin me ndërkombëtarët?

2 PË. A mund të sqaroj pak, ju lutem?

3 PY. Patjetër.

4 PË. Ju kërkoj ndjesë, sepse do të jetë një leksion sadopak i
5 shkurtër për atë që kemi kuptuar ne në atë kohë dhe ashtu e
6 kuptojmë edhe tani, origjinat e UÇK-së.

7 Pra, mënyra se si e kemi kuptuar ne, ka qenë që në thelb
8 gjërat nuk kanë ndryshuar në kohë, që UÇK-ja ka pasur, të
9 themi, dy krerë. Ajo UÇK-ja origjinale, fillestare, ka qenë
10 një bërje bashkë e atyre që do t'i shpjegoja si një Forcë
11 Mbrojtjeje Territoriale. Dhe ne në fakt në raportimet tona,
12 për Uashingtonin, i kemi quajtur pra personat që kishin të
13 bënin me grupe civilësh që i kemi quajtur si ata që ishin
14 civilët amerikanë që luftonin kundër trupave ushtarake
15 britanike në revolucionin tonë, në vitet 1700. Dhe ne të
16 njëjtën terminologji kemi përdorur dhe për këta, sepse mbronin
17 shtëpitë e tyre dhe familjet e tyre. Dhe ndjesia që ne kemi
18 patur, ka qenë që këto grupe janë përpjekur, pra, që në fillim
19 të viteve 1990 kanë krijuar një luftë, si me thënë, kundër
20 aparatit shtypës të forcave të Slobodan Millosheviqit në
21 Kosovë. Dhe disa nga ato tmerret që u janë bërë shqiptarëve,
22 kanë filluar, si për shembull, djegia e fshatrave, ose marrja
23 e sendeve personale, pronave, këto lloj gjërash. Me kohë u pa
24 që ishte një kryengritje e plotë që po fillonte në atë kohë,
25 dhe e cila udhëhiqej nga liderë individualë që pastaj u kthyen

1 në komandantë individualë të zonave.

2 Në Zvicër, në diasporën shqiptare, e cila ishte shumë
3 ideologjike, ata e panë kryengritjen si një mënyrë për të
4 arritur objektivat e tyre. Pra, kishte dy grupe në diasporë,
5 kështu e kemi kuptuar ne. Një grup ishte pro çlirimit të
6 Kosovës dhe shndërrimit të saj në një shtet të pavarur, pra
7 një shtet tërësisht i pavarur nga Serbia, pra jashtë Serbisë,
8 jashtë Jugosllavisë. Ndërkohë që kishte dhe një grup tjetër, i
9 cili ishte opsioni një, por plus një, që ishte çlirimi i
10 Kosovës nga Serbia dhe ribashkimi me Shqipërinë e Hoxhës.

11 Dhe këta, ky, në mes të viteve 1990, ndoshta nga 1993 e
12 tutje, e panë këtë kryengritje, këtë zhvillim të kryengritjes,
13 si një platformë që duhej krijuar. Dhe më pas, në 1997, 1998,
14 u kthyen një pjesë e kësaj diaspore, dhe këta persona nga
15 diaspora si Xhavit Haliti apo Hashim Thaçi, u kthyen në Kosovë
16 nga Zvicra, dhe me pak fjalë ata ofruan ndërveprimin me
17 komunitetin ndërkombëtar, sepse ata kuptuan, zotëri, faktin që
18 pas Dejtonit, marrëveshjes së Dejtonit, në 1995, Kosova kishte
19 pak gjasa që të bëhej e pavarur pa ndërhyrjen e
20 ndërkombëtarëve, por në veçanti të Shteteve të Bashkuara të
21 Amerikës.

22 Megjithatë, do të thosha që ai melazh i këtyre Forcave të
23 Mbrojtjes Territoriale, apo i këtyre personave që po luftonin
24 kundër serbëve, nuk mund të bënin këtë gjë vetë, por kishin
25 nevojë për një ministri të jashtme, pra kishin nevojë për disa

- 1 persona që të arrinin të komunikonin me komunitetin
2 ndërkombëtar, prandaj këta zotërinj u kthyen që të bënin
3 pikërisht këtë gjë. Dhe kjo ishte gjëja domethënë me pak
4 shpejtësi që do, ai leksioni që ju foli më parë.
5 PY. A do të kisha të drejtë të thosha që takimi me
6 Christopher Hill ka qenë një diskutim për të ardhmen e Kosovës
7 dhe për çështje diplomatike dhe politike se sa çështje
8 ushtarake?
9 PË. Në cilën datë?
10 PY. Në datën 6 nëntor.
11 PË. Po.
12 PY. Kontaktet tuaja kryesore me UÇK-në përpara se të arrinit
13 ju atje, keni thënë në intervistën tuaj të ZPS-së, kanë qenë
14 Sylejman Selimi dhe Rexhep Selimi, është e saktë?
15 PË. Po. Në fakt ata kanë qenë zyrtarët e parë të UÇK-së të
16 cilët unë kam takuar.
17 PY. Dhe më pas, pasi arritët atje, ju diskutuat edhe me
18 trojkën, u takuat me ta, është e saktë kjo?
19 PË. Po. Pak më vonë ne kemi takuar dhe trojkën, z. Krasniqi,
20 Bujën dhe Shotën [Sipas përkthimit].
21 PY. Dhe kjo ka qenë një periudhë rreth dyjavore, në fund të
22 tetorit, fillim të nëntorit, dhe ju pastaj jeni takuar me z.
23 Thaçi?
24 PË. Sipas ditarit tim, po.
25 PY. Dhe më pas, ju keni thënë që z. Thaçi u largua nga Kosova

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 93

1 në mes të nëntorit, me ç'dini ju?

2 PË. Me ç'dija unë, po.

3 PY. Pasi z. Thaçi u largua në mes të nëntorit të vitit 1998,
4 a është e saktë që ju e keni takuar atë më pas në kohën e
5 Rambujesë, në shkurt të 1999?

6 PË. Po. Por, a mund t'i kthehemi edhe një herë takimit në
7 fillim të nëntorit dhe në fund të tetorit? Ndoshta duhet të
8 kisha qenë pak më i qartë lidhur me këto takime.

9 PY. Këto takime -- në veçanti takimi i fillimit të nëntorit,
10 është shtyrë nga ajo çfarë ne e kemi quajtur ndryshe si
11 marrëveshja e tetorit, që është marrëveshja ndërmjet
12 Milosheviqit dhe Holbrooke, e arritur në Beograd më datë 30
13 tetor, dhe që çoi në krijimin e misionit të OSBE-së që më pas
14 u njoh si KVM, Komisioni Verifikues i Kosovës. Mbjaj mend që
15 neve na ngarkoi si detyrë Sekretari i Shtetit që të
16 kontaktonim me UÇK-në që nuk ishte palë e kësaj marrëveshjeje,
17 pra Sekretari i Shtetit neve na kërkoi që të mundoheshim që të
18 takoheshim me zyrtarët e lartë të UÇK-së në mënyrë të tillë që
19 t'u shpjegonim atyre përmbajtjen e marrëveshjes edhe t'u bënim
20 thirrje atyre që ta pranonin këtë marrëveshje. Dhe, në qoftë
21 se do ishte e mundur që ta nënshkruanin atë. Por në qoftë se
22 nuk do ta nënshkruanin, ta pranonin dhe ta zbatonin atë. Pra
23 kjo ka qenë përparësia kryesore e këtyre takimeve.

24 PY. Do merremi dhe me këtë çështje. Ju po thoni, Dëshmitar,
25 që ju e kuptuat që këto ish-in marrëveshjet që i dhanë

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 94

1 legjitimitet Shtabit të Përgjithshëm në sytë e UÇK-së në
2 terren, kështu është apo jo?

3 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na jepni
4 referencën për këtë?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, kjo është në
6 deklaratën e dëshmitarit [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Ju lutem, një sekondë --

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni të përfundoj, përderisa
12 e kërkoi këtë referencë.

13 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Në qoftë se do të citoni nga
14 kjo pjesë, keni parasysh që është një pjesë në këtë dokument
15 që duhet të jetë i mbrojtur, thjesht dua t'ia sjell në
16 vëmendje avokatit këtë gjë, se jemi në seancë të hapur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkuat
18 citimin, po ju jep citimin Avokati.

19 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Po them që nuk duhet të
20 lexohet në seancë të hapur, sepse përmban informacione të një
21 dëshmitari të mbrojtur.

22 Atëherë, unë ju kërkova referencën sepse nuk na u dha
23 referenca.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani doni që
25 të kalojmë në seancë private?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 95

1 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Jo, nuk po them që dua të
2 shkoj në seancë private, unë kërkova referencën, referenca u
3 dha. Në qoftë se dëshiron Mbrojtja që të vazhdojë me leximin e
4 kësaj pjese, atëherë do të duhet të kalojmë në seancë private.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
6 doni që ta lexoni këtë pjesë të deklaratës?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të
9 kalojmë në seancë private.

10 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Thjesht dua të sugjeroj që
11 në qoftë se do të jemi pak më të qartë, nuk është e nevojshme
12 që ta bëjmë këtë gjë, që të hyjmë në seancë private publike
13 për aq kohë sa jepet referenca e plotë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vazhdoni.

16 Sekretare, na kaloni në seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 96

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kalojmë në seancë
21 publike.

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Atëherë, sa për publikun, a është e qartë apo është e

24 saktë që nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve nga mesi i tetorit

25 i ka dhënë Shtabit të Përgjithshëm legjitimitet dhe ndikim? A

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 97

1 është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Herën tjetër kur ju u takuat me z. Thaçi pasi u largua
4 nga mesi i nëntorit, ka qenë në shkurt të 1999 gjatë kohës pak
5 a shumë domethënë rreth kohës së Rambujesë, ka qenë kështu,
6 Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe e keni parë, e keni takuar z. Thaçi në Francë, apo
9 jo, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Thoni, në intervistën e ZPS-së që është prova materiale e
12 pranuar tanimë, 01066 në faqen 17, paragrafin 74, që -- me sa
13 kishit kuptuar ju, ai kishte shkuar në Evropë që të mblidhte
14 fonde nga diaspora dhe të takohej me zyrtarë amerikanë dhe
15 evropianë për mbështetjen e Kosovës, a është e saktë kjo,
16 Dëshmitar?

17 PË. Po.

18 PY. Po mundohem që të lëmë pak hapësirë në mënyrë të tillë që
19 t'u japim kohë përkthyesve.

20 PË. Në rregull.

21 PY. Ju shtoni që në takimin e z. Thaçi dhe me zyrtarë
22 qeveritarë të lartë ju sugjeroni që z. Thaçi e kuptonte që
23 donte që të kishte më shumë influencë ose më shumë ndikim, në
24 mënyrë të tillë që të mund të përçonte siç duhej mesazhet e
25 drejta. A pajtoheni me mua, Dëshmitar?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 98

1 PË. Po.

2 PY. A pajtoheni me mua që do ishte kundër-produktive në
3 raport me përpjekjet e z. Thaçi që të takohet me zyrtarë
4 amerikanë dhe evropianë që të mbështeste në të njëjtën kohë
5 edhe kryerjen e krimeve të luftës në terren, a nuk do ishte
6 kjo pa vend, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Tani dua të kalojmë në një tjetër temë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] E kam fjalën për provën materiale
10 P1074. Që është një faksimile tjetër që mban datën 4 shkurt
11 1998. Jepet në faqen 075341.

12 PY. Së pari, a e dini kush e ka hartuar këtë faksimile, e
13 keni hartuar juve ose e ka bërë ndonjë njeri tjetër në emrin
14 tuaj?

15 PË. Mendoj se e kam përgatitur unë. Zakonisht kam qenë unë
16 personi që e kam shkruar tekstin e faksimileve të tilla, por
17 gjatë shkrimit të tyre jam mbështetur tek raportet e personave
18 që punonin në terren.

19 PY. Në rregull.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të shkojmë
21 në fund të faqes.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë,
23 Avokat, ju lutem përsërisni dhe një herë numrin e faqes.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, 075341.

25 PY. Këtu, mbas fjalës "e vështirë"; thuhet si më poshtë:

1 "Në kohën kur Shtabi i ri i Përgjithshëm po përpiqej që
2 të punonte që struktura e UÇK-së të kishte një lloj organizimi
3 ushtarak koherent, dhe për të marrë pjesë, dhe për të pasur
4 autoritet mbi liderët ushtarakë rajonalë të pavarur, ishte e
5 pamundur politikisht që disa komandantë zone t'iu
6 kundërviheshin trupave të komandantëve të tjerë. Pra kishte
7 shumë pak të ngjarë që disa komandantë të zonës t'i dorëzonin
8 trupat e tyre komandantëve të zonave të tjera."

9 Pra, me fjalë të tjera, Dëshmitar, në këtë faksimile,
10 përmendet diskutimi i përpjekjeve të Shtabit të Përgjithshëm
11 për të ulur zonat e UÇK-së nga pesë në tre, pra të shkurtohej
12 numër i zonave nga pesë në tre, dhe kjo është diçka që ju e
13 mbështesni në këtë faksimile në paragrafin 6 aty. Aty thoni
14 që:

15 "Burimet tona në UÇK pretendonin se Shtabi i Përgjithshëm
16 kishte arritur në përfundimin që do ishte mirë që të
17 reduktohej numri i zonave të UÇK-së në të ardhmen. Megjithatë,
18 një gjë e tillë ishte shumë e vështirë për t'u arritur."

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen tjetër,
20 Sekretare.

21 PY. Kjo është pjesa tjetër që unë e lexova pak më përpara. Ju
22 thatë që ishte shumë e vështirë që të konsolidoheshin zonat,
23 ishte e vështirë të bëhej ky konsolidim për shkak të
24 udhëheqësve të pavarur ushtarakë të zonave, të pavarësisë së
25 madhe, pra, që kishin udhëheqësit ushtarakë të zonave. A është

1 e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, është e saktë kjo.

3 PY. Mund ta shtjelloni më tej, nëse doni.

4 PË. Ja një çast, ju lutem. Çfarë date mban kjo faksimile?

5 PY. 4 shkurt 1999.

6 PË. Nuk ju dëgjoj mirë, dëgjova vetëm datën 4 shkurt. Ju
7 lutem, flisni pak me zë më të lartë për t'ju dëgjuar. Do të
8 përpiqem që të flas pak më ngadalë krahasimisht me se ç'kam
9 folur më herët, për t'i dhënë kohë përkthyesve për të më
10 përkthyer plotësisht.

11 Është pak histori kjo çfarë do ju them. Pas 30 tetorit,
12 pas marrëveshjes ndërmjet Milosheviqit dhe Holbrooke, u arrit
13 një lloj paqeje e një lloji, e njëfarë lloji. Por herë pas
14 here kjo paqja ndërpritej sepse kishte shpërthime papritmas,
15 të luftimeve ndërmjet dy kaheve. Të dyja kahet u munduan që të
16 konsolidonin pozicionet e tyre, pra të përdornin këtë periudhë
17 në mënyrë që të konsolidoheshin, gjë për të cilën ne ishim
18 shumë të informuar, ishim të vetëdijsëm për këtë gjë. Dhe
19 KVM-ja, që kishte burimet e veta që ishin rritur burimet e
20 veta, dhe ne kemi, domethënë KVM-ja në atë kohë vëzhgonte të
21 dyja palët, të dyja anët, edhe serbët, edhe UÇK-në. Disa prej
22 burimeve të larta të UÇK-së na e kanë thënë shumë qartazi që
23 UÇK-ja në atë kohë po riorganizohej duke i paraprirë faktit që
24 në pranverë serbët do t'i sulmonin ata, kështu që për këtë
25 arsye ata po rekrutonin, po riarmatosnin, po trajnoheshin në

1 mënyrë që të përgatiteshin për sulmet e mundshme të pranverës.

2 Unë po ju jap analizën që kemi bërë ne në atë kohë, që
3 mbase mund të konsiderohen si spekulim këtu, nga ju, dhe në
4 qoftë se e mendoni si spekulim, ju lutem, më ndërprisni në çdo
5 moment. Megjithatë, ndjesia jonë atëherë ishte se e dinim prej
6 kontakteve tona në terren, pra, kishim stacionet e KDOM-it, që
7 më pas u morën nga KVM-ja, pra kishim stacionet tona në Pejë,
8 në Drenoc, në Podujevë, në Suharekë, Ferizaj, dhe në vende të
9 tjera nëpër të gjithë Kosovën. Dhe këto stacione në nivel
10 lokal, ishin në kontakte të vazhdueshme me komandantët e
11 zonës.

12 Ne e dinim që kishte rezistencë ndaj riorganizimit të
13 zonave të UÇK-së nga shtatë në tre. Megjithatë, disa prej
14 komandantëve të zonave, dhe në veçanti Remi, që ishte
15 komandant i zonës së Llapit, edhe z. Ramush Haradinaj nga zona
16 e Dukagjinit, pra komandanti i zonës së Dukagjinit, ata të dy
17 shprehimisht na kishin thënë që ishin kundër këtij
18 riorganizimi. Dhe ishin kundër që të ishin plotësisht të varur
19 ose nën varësinë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që u
20 organizua diku nga fundi i verës. Ata kishin këtë qëndrim, ose
21 ishin kundër, sepse kishin mundësi të rezistonin. Ata kishin
22 burimet e veta, kishin financimet e veta, dhe kishin mjetet e
23 veta për të siguruar armatime.

24 Po ju them një anekdotë. Remi, që ishte komandanti i
25 Llapit, na ka thënë që ai po blinte armë nga një kolonel i

1 Ushtrisë Jugosllave në shtabin e korpusit të Prishtinës, në
2 Nish, në Serbi. Dhe koloneli do i dërgonte një kamion plot me
3 armë deri në Podujevë, dhe marrëveshja ishte që ai t'i
4 dërgonte në mënyrë të vazhdueshme periodike këto armë në
5 mënyrë të tillë që armët t'i jepeshin UÇK-së dhe ai të merrte
6 pagesën për këtë në marka gjermane, në mos gaboje. Domethënë
7 ideja ishte që do të sillte armë në këmbim të parave.

8 Ne, me sa dinim, Rahman Rama, në zonën e Shalës po bënte
9 të njëjtën gjë. Dhe Ramushi vetë të njëjtën gjë më ka thënë,
10 pak a shumë, dhe ai po bënte të njëjtën gjë. Kështu që nga
11 pikëpamja analitike, nga pikëpamja e analizës, UÇK-ja nuk
12 është se kishte influencë mbi këta persona dhe këta persona
13 kishin ndjesitë e veta të pavarësisë, ishin të pavarur për
14 shkak të burimeve dhe ata sa i takon aspekteve ushtarake mund
15 të bënin çfarëdolloj gjëje që ata mendonin se u shërbente më
16 mirë atyre.

17 Do ta përfundoj këtu, shpresoj që t'ju kem ndihmuar
18 sadopak.

19 PY. Po, patjetër. Na ndihmuat. Faleminderit për përgjigjen.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani më lejoni që t'ju tregoj
21 tekstin e një tjetër faksimileje. Për procesverbal është prova
22 materiale 01080. I kërkoj Sekretares që të paraqesë dokumentin
23 075396. Kjo është një faksimile e datës -- 10 mars. Data 10
24 mars, nga ambasada e Beogradit. Le të lexojmë duke filluar nga
25 paragrafi 4 i këtij dokumenti.

1 PY. Do ju kërkoja që ta lexonit vetë, Dëshmitar. Por fillon
2 me diçka të ngjashme me atë çfarë thatë juve. Thuhet këtu që:

3 "Komandantët e zonave janë kryesisht anëtarë themelues të
4 UÇK-së, individë të tillë si komandanti i zonës së Podujevës,
5 Rrustem Mustafa (Remi), komandanti i zonës së Drenicës, Sami
6 Lushtaku, dhe komandanti suprem i UÇK-së Sylejman Selimi,
7 ndjejnë krenari të tepërt që kanë armët në duart e tyre për të
8 luftuar kundër serbëve, dhe kanë vënë në rrezik jetën e tyre
9 për të siguruar pavarësinë e Kosovës, ndërkohë që Rugova dhe
10 politikanë dhe struktura të tjera intelektuale janë në hije."

11 Nuk e di në qoftë se e shikoni këtë, Dëshmitar?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Pastaj kalojmë tek fjalia e
13 parafundit.

14 PY. Ku ju thoni që: "Në fakt, një prej çështjeve kryesore
15 brenda UÇK-së gjatë muajve të fundit ka qenë lufta për
16 influencë, apo për ndikim brenda Shtabit të Përgjithshëm
17 ndërmjet degëve politike dhe ushtarake të UÇK-së.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë tek faqja tjetër. Tek
19 mesi i faqes, ju lutem.

20 PY. "Zëvendësimi i Azem Sylës si komandant i UÇK-së nga
21 Sylejman Selimi është një manifestim i kësaj lufte të
22 brendshme."

23 Dëshmitar, i takon që jeni në dijeni të faktit që ajo
24 çfarë ka ndodhur në shkurt, që Sylejman Selimi ishte bërë
25 komandant në vend të Azem Sylës, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. A është e vërtetë që kjo faksimile tregon këtë luftën e
3 brendshme ndërmjet degës politike dhe degës ushtarake të UÇK-
4 së?

5 PË. Po. A mund ta shtjelloj më tej?

6 PY. Po.

7 PË. Pak më -- pak historik për ta kuptuar më qartë kontekstin
8 e kësaj faksimileje. Autori i kësaj faksimileje jam unë. Unë e
9 kam shkruar atë. UÇK-ja nuk kishte besim tek Presidenti
10 Rugova. Presidentin Rugova ata e shihnin si dikënd që ishte i
11 gatshëm të pranonte nën presionin e bashkësisë ndërkombëtare,
12 pra ata e shikonin si një person që ishte i gatshëm të
13 pranonte një marrëveshje që e linte Kosovën si pjesë të
14 Serbisë, edhe pse sipas kushtetutës së 1974, Kosova ishte
15 gjerësisht e pavarur. Megjithatë, me fjalë të tjera, UÇK-ja
16 nuk kishte besim te Rugova. UÇK-ja luftonte për pavarësi të
17 plotë.

18 Tani, në goftë se do të kalojmë tek fërkimi ndërmjet
19 degës politike dhe ushtarake të UÇK-së, ose konfliktet e
20 brendshme që ekzistonin ndërmjet këtyre dy degëve. Mënyra se
21 si kuptoja unë situatën në atë kohë, që ishte mbështetur tek
22 diskutimet midis udhëheqësve të UÇK-së dhe njerëz, pra
23 shqiptarë të Kosovës, të cilët ishin afër UÇK-së, por nuk
24 ishin anëtarë të UÇK-së, si për shembull, gazetarë, si
25 gazetari i njohur i asaj kohe, Veton Surroi, apo Blerim Shala,

1 Neziri [Sipas përkthimit], që ka qenë një tjetër gazetar i
2 njohur, ose Baton Haxhiu, i *Kohës Ditore* ose persona të tjerë,
3 pra, gazetarë, edhe njerëz me influencë që ishin pranë UÇK-së.

4 Pra, dega ushtarake, dhe komandantët e zonave, dëshironin
5 që të vazhdonin me luftimet, pra donin që t'i vazhdonin më tej
6 luftimet, derisa të çlirohej Kosova. Dhe ata ishin të
7 shqetësuar që Drejtoria Politike që në atë kohë ishte në
8 negociata, në bisedime, me ndërkombëtarët, në veçanti pas
9 hapjes së bisedave në Rambuje, do të binin dakord me diçka që
10 ishte më pak se sa pavarësia e plotë e Kosovës. Ata e dinin se
11 udhëheqja e UÇK-së dhe komandantët e zonave e dinin se
12 dokumentet që ambasadori Hill do të ofronte në Rambuje,
13 parashikonin një Kosovë që do të mbeste brenda Serbisë, por që
14 do të kishte kompetenca vetëqeverisëse.

15 Si e dinin ata këtë gjë? Ata e dinin këtë gjë sepse
16 Hashim Thaçi kishte mbledhur një takim në Shtabin e UÇK-së në
17 Lladrovc përpara bisedave dhe negociatave në Rambuje. Pra,
18 atje Thaçi kishte mbledhur komandantët e zonave dhe iu kishte
19 shpërndarë dokumentin e Hill duke iu shpjeguar se çfarë
20 përmbante ky dokument. Pra, kjo për shkak të kësaj, Adem
21 Demaçi, domethënë pasi u largua Hashim Thaçi dhe delegacioni,
22 dhe shkuan në Rambuje. Pra, drejt fundit të fazës së
23 Rambujesë, pra, pjesa e dytë e procesit ishte takimi në Paris,
24 që u bë më vonë. Megjithatë kjo sjellje e çoi Demaçin që të
25 largohet, të bënte thirrje që të largoheshin palët nga ky

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 106

1 dokument, dhe si rezultat, Sylejman Selimi mori kontrollin të
2 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ndërkohë që Thaçi dhe
3 anëtarët e tjerë të delegacion ishin në Rambuje.

4 Domethënë me pak fjalë kjo ishte ajo çfarë ka ngjarë, kjo
5 ishte historiku i asaj kohe.

6 PY. Ju e dinit që Adem Demaçi kishte ndikim?

7 PË. Ju lutem, më pranë mikrofonit.

8 PY. Po. Ju e dinit që Adem Demaçi kishte ndikim mbi
9 komandantët e zonave, apo nuk ishte kështu, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
12 kundërshtojmë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. Përgjigjja është po.

15 Ai kishte ndikim të madh sepse me Remin, komandant Remin,
16 ishin nga e njëjta zonë, vinin të dy nga zona e Llapit dhe
17 kishin ndikim të madh mbi njëri-tjetrin. Ndërkohë që Remi
18 ishte shumë kundër asaj marrëveshje, nuk ishte fare dakord me
19 atë marrëveshje.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Në fakt, a është e saktë që i keni thënë ZPS-së në provën
22 materiale P01066 në paragrafin 43, se pas marrëveshjes së
23 tetorit, dokumentet e nënshkruara nga Adem Demaçi ju bënë ju
24 të mundur që të lëviznit në zonat që ishin në kontrollin e
25 UÇK-së, apo jo?

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 107

1 PË. Po.

2 PY. Domethënë, me fjalë të tjera, ju kishit dokument të
3 nënshkruar nga Adem Demaçi dhe kur u paraqisnit këtë dokument
4 ju mund të kalonit në zonat që kontrolloheshin nga UÇK-ja?

5 PË. Po. Shpeshherë ndodhte kështu.

6 PY. Sylejman Selimi ishte komandant i zonës së Drenicës,
7 përpara se sa të bëhej komandant i përgjithshëm i UÇK-së apo
8 jo? A e keni këtë informacion, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Siç duket ai ishte pjesë e kësaj ndarje, në qoftë se mund
11 ta quaja kështu, ose revolte, nëse mund ta quaja kështu, ose
12 në Kosovë, ky proces është njohur ndonjëherë kështu si grusht
13 shteti në shkurt të 1999 që çoi në zëvendësimin e Azem Sylës
14 me Sylejman Selimin si komandant, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Po, keni të drejtë.

16 PY. Nuk u reflektua në procesverbal, a mund ta thoni edhe një
17 herë tjetër?

18 PË. Po, keni të drejtë. Jam plotësisht dakord me ju.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, mbase do
20 ishte momenti i përshtatshëm ky për ta mbyllur dhe për të bërë
21 pushimin e drekës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ardhur
23 koha të bëjmë pushimin e drekës. Do bëjmë pushim tani. Nga ora
24 13.00 deri në orën 14.30. Pas orës 14.30 do vazhdojmë më tej,
25 Dëshmitar.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 108

1 Z. Laws, kishit diçka për të thënë?

2 Z. LAWS: [Përkthim] Harrova që të ofroja si dokumente për
3 t'u pranuar si provë materiale dy dokumente që përdora me
4 dëshmitarin pak më herët.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

6 Z. LAWS: [Përkthim] Në rregull. Dokumentet që përdora
7 janë këto: V0070028, edhe artikulli i *New York Times* është
8 dokumenti 062427-10 dhe videoja sigurisht.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
10 kundërshtim Prokuroria? Ndonjë kundërshtim nga Mbrojtja e z.
11 Thaçi?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Dokumenti V0070028 dhe 061427-10 pranohen të dy si prova
15 materiale. Dhe do të caktohet një numër prove materiale,
16 secili prej këtyre dokumenteve.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, të nderuar
18 Gjykatës. Për sqarim, videoja me numër ERN 061427-10 është
19 pranuar si provë materiale sot paradite si pjesë e materialeve
20 shoqëruese me numër prove materiale P01087.

21 Dokumenti i dytë, që aktualisht mban numrin V0070028 deri
22 në V0070028 do të marrë numrin e provës materiale V00007, dhe
23 do të klasifikohet si dokument konfidencial.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
25 Faleminderit.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 109

1 Asistente, mund ta nxirrni dëshmitarin nga salla.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe sa kohë
4 ju duhet për të bërë kundërpjetjet, z. Misetiç?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Do më duhet deri në fund të ditës,
6 pa diskutim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Do bëjmë pushim deri në orën 14.30.

9 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

10 --- Seanca rifillon në orën 14.30

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
12 uleni.

13 Përpara se të vijë dëshmitari më duhet të them që sot
14 paradite, fakti që kanë hyrë dhe kanë dalë shumë njerëz në
15 zyrë, na kanë çorientuar dhe kanë çorientuar edhe disa herë
16 dëshmitarin. Ju lutem, kur duhet të dilni nga salla e gjyqit,
17 për arsyet tuaja, ju lutem dilni kur të jetë patjetër e
18 domosdoshme, dhe dilni me qetësi në mënyrë që të mos
19 ndërprisni personat, dhe veçanërisht dëshmitarin.

20 Gati jemi. Ju lutem të sillni dëshmitar në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
23 Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëdita.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vijojmë

- 1 me pyetjet e z. Misetić. Ju lutemi kushtojini vëmendjen.
- 2 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.
- 3 Z. MISETIĆ: [Përkthim] Faleminderit.
- 4 PY. Mirëdita, z. Byrnes. Më dëgjoni?
- 5 PË. [Nuk ka përkthim]
- 6 PY. Në rregull. Gjergj Dedaj, i cilës parti ishte?
- 7 PË. Me sa më kujtohet, është Partia Liberale Demokratike.
- 8 PY. S'ishte LDK-ja kjo?
- 9 PË. Ishim partnerë por, ishin të ndryshëm. Ishim të ngjashëm
- 10 por të ndryshëm.
- 11 PY. Po Agim Krasniqi?
- 12 PË. Ishte i zyrtar i lartë i LDK-së.
- 13 PY. Pra, ishin në parti të ndryshme politike?
- 14 PË. Po.
- 15 PY. Në bllokun tuaj keni shënime ku thoni se keni marrë një
- 16 thirrje telefonike nga z. Dedaj më 23 shtator. Ju kujtohet
- 17 kjo?
- 18 PË. Po.
- 19 PY. Ka edhe një shënim tjetër për të nesërmen, por nuk thotë
- 20 a ka qenë takim, a ka qenë thirrje telefonike. Po kjo ju
- 21 kujtohet?
- 22 PË. Më kujtohet që kemi mbajtur kontakt po a -- nuk më
- 23 kujtohet a ka ndodhur përmes thirrjeve telefonike apo takimit.
- 24 PY. Do ju kujtohej nëse do ta kishit takuar z. Dedaj, do ju
- 25 kujtohej në qoftë se -- do ju kujtohej z. Dedaj në qoftë se do

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 111

1 të kishte qenë në pamje fizike jo të mirë?

2 PË. Kur e kam parë pas lirimit nuk ishte në gjendje të keqe
3 shëndetësore.

4 PY. A ua dha dorën?

5 PË. Nuk më kujtohet. Mbase po.

6 PY. Po a do ju kujtohej -- do ju kujtohej në qoftë se nuk do
7 ua jepte dorën?

8 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] Kundërshtoj. Kjo kërkon
9 spekulim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
11 Vazhdoni.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Nuk keni shënime lidhur me ato që keni diskutuar me z.
14 Dedaj në shtator të vitit 1998. Kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Nuk ju kanë treguar ndonjë faksimile diplomatik që të
17 flasë për ngjarjet e Qirezit. Kështu?

18 PË. Nuk e di.

19 PY. A ju kujtohet t'ju ketë treguar Prokurori ndonjë
20 faksimile që të përmend ngjarjet e Qirezit në mes ose fund
21 dhjetori --

22 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] A mund të na jepni periudhën
23 kohore për këtë?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 112

1 PY. Do ta them edhe një herë pyetjen. Prokurori a ju tregoi
2 ndonjë faksimile që përmend ngjarjet në Qirez në fund -- në
3 mes dhe në fund të shtatorit në vitin 1998.

4 Z. FERDINANDUSSE: [Përkthim] E kundërshtoj, se pyetja
5 këtu nuk është për periudhën kohore -- kundërshtimi nuk ishte
6 për periudhën kohore në Qirez por kur i është treguar apo jo
7 nga Prokuroria kjo faksimile.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni edhe
9 një herë pyetjen.

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Me sa ju kujtohet ju, ZPS-ja në ndonjë moment, ju ka
12 treguar ndonjë faksimile ku të përmendet ajo që ka ndodhur në
13 Qirez në mes ose në fund të shtatorit të vitit 1998?

14 PË. Po.

15 PY. Çfarë ju kujtohet nga ajo që keni parë?

16 PË. Përshkruajmë atje ato që kishim mësuar nga personat apo
17 nga anëtarët e grupit që u liruan. Përmendim -- përmendnim --
18 përshkruanim mënyrën se si ishin trajtuar.

19 PY. Do ju tregoj diçka dhe të shohim nëse po flasim për të
20 njëjtën gjë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Fatkeqësisht, për këtë duhet të
22 kalojmë në seancë private. I nderuar Gjykatës, do ju lutesha të
23 kalonim në seancë private.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të
25 kalojmë në seancë private.

Dëshmitari: Shaun Byrnes (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 113

- 1 [Seancë private]
- 2 [Seancë private teksti i fshirë]
